



Programi për Fëmijët e Ndarë në Europë
DEKLARATË E PRAKTIKAVE TË MIRA

Botimi i Tretë, 2004



Save the Children



UNHCR
The UN Refugee Agency

PËRMBAJTJA

A. Hyrje	2
1. Programi për Fëmijët e Ndarë në Europë (SCEP)	2
2. Përkufizimi	2
3. Deklarata e Praktikave të Mira	3
4. Shkurtime dhe Akronime të përdorura për referime	4
B. Parimet Bazë	7
B 1. Interesat më të mira	7
B 2. Mosdiskriminimi	7
B 3. E drejta për Pjesëmarrje	8
B 4. Respekti për Identitetin Kulturor	8
B 5. Interpretimi	9
B 6. Fshehtësia	9
B 7. Informimi	10
B 8. Bashkëpunimi midis Organizatave	10
B 9. Formimi i Personelit	11
B 10. Jetëgjatësia	11
B 11. Koha	11
C. Praktikave të Mira	12
C 1. Hyrja në Territor	12
C 2. Fëmijët Viktima të Trafikimit	13
C 3. Fëmijët e Ndarë Migrues	14
C 4. Identifikimi	15
C 5. Kërkimi i Familjeve dhe Kontaktet me to	15
C 6. Caktimi i një Kujdestari ose Këshilluesi	16
C 7. Regjistrimi dhe Pajisja me Dokumenta	17
C 8. Përcaktimi i Moshës	18
C 9. Liria nga Arresti	18
C 10. E drejta për Pjesëmarrje	19
C 11. Kujdesi i Përkohshëm - Shëndeti, Edukimi dhe Formimi	20
C 11.1 Kujdesi i Përkohshëm	20
C 11.2 Shëndeti	21
C 11.3 Edukimi, Gjuha dhe Formimi	22
C 12. Procesi i Azilit ose i Përcaktimit të Statusit të Refugjatit	24
C 12.1 Garancitë Procedurale Minimale	25
C 12.2 Kriteret për marrjen e një vendimi mbi kërkesën e fëmijës	26
C 13. Zgjidhjet e Qëndrueshme ose Afatgjata	28
C 13.1 Qëndrimi në një Vend Pritës / Vend Azili	28
C 13.2 Bashkimi familjar	28
C 13.3 Integrimi	29
C 13.4 Birësimi	30
C 13.5 Identiteti dhe Nënshpëtim	31
C 13.6 Kthimi në Vendin e Origjinës	31
Shtojca I, E kaluara Shoqërore	33
Shtojca II, E Drejta, Politikave dhe Udhëzimet Ndërkombëtare e Rajonale	34
Shtojca III, Referenca	37

A. HYRJJE

1. Programi për Fëmijët e Ndarë në Europë (PFNE)

PFNE është një nismë e përbashkët e Aleancës Ndërkombëtare Save the Children dhe e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Programi bazohet në mandatet plotësues dhe fushat e kompetencave të të dy organizatave.

Përgjegjësia e UNHCR-së është të garantojë mbrojtjen e fëmijve refugjatë dhe të atyre që kërkojnë azil. Aleanca Ndërkombëtare Save the Children ka për detyrë të vëzhgojë zbatimin e plotë të të drejtave të të gjithë fëmijëve.

Programi synon të mbrojë të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijëve të ndarë të cilët kanë ardhur ose kalojnë nëpër Europë, duke krijuar një politikë të përbashkët dhe duke u angazhuar në praktikat më të mira në nivel kombëtar dhe europian. Në kuadrin e këtij procesi, programi po krijon partneritet me organizata që punojnë me fëmijët e ndarë në vendet e Europës.

2. Përkufizim

“Fëmijët e ndarë” janë fëmijë nën 18 vjeç të cilët ndodhen jashtë vendit të origjinës dhe janë të ndarë nga të dy prindërit, ose nga kujdestarët e tyre të mëparshëm ligjorë. Disa fëmijë janë krejtësisht të vetëm ndërsa disa të tjerë, të cilët janë gjithashtu pjesë e interesimit të PFNE-së, mund të jetojnë me pjesëtarë të familjes së tyre të zgjeruar. Të gjithë këta fëmijë janë fëmijë të ndarë dhe kanë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare mbi bazën e një game të gjerë mjetesh ndërkombëtare dhe rajonale. Fëmijët e ndarë mund të kërkojnë azil për shkak të frikës nga përndjekja ose për shkak të mungesës së mbrojtjes si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut, konfliktit të armatosur ose trazirave në vendin e tyre. Ata mund të jenë viktimat e trafikimit për qëllime seksuale ose qëllime të tjera shfrytëzimi, ose mund të kenë ardhur në Europë për t’i shpëtuar një situatë mungesash të rënda. (CRC, Nenet 1 & 22; Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve, 1996, Neni 6; Udhëzimet e UNHCR, parag.3.1; ECRE (Fëmijët) parag. 8 & 11; Rezoluta e BE mbi të Miturit e Pashoqëruar, Neni 1(1); Protokollin për Parandalimin, Zhdukjen dhe Dënimin e Trafikimit të Njerëzve, Veçanërisht të Grave dhe fëmijëve, Nenet 2a & 3d; Protokollin Kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, Nenet 14 & 19).

Programi për Fëmijët e Ndarë në Europë përdor fjalën “i ndarë” dhe jo “i pashoqëruar” sepse ky term përcakton më mirë problemin thelbësor me të cilin ndeshen këta fëmijë. Çka do të thotë që atyre u mungon kujdesi dhe përkrahja e prindërve ose përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe si pasojë vuajnë, nga pikëpamja shoqërore dhe psikologjike, këtë ndarje. Ndonëse disa fëmijë të ndarë ngajnë të jenë “të shoqëruar” kur mbërrijnë në Europë, të rriturit që i shoqërojnë nuk janë domosdoshmërisht të aftë ose të përshtatshëm për të marrë përsipër përgjegjësinë për t’u kujdesur për ta.

“Mbrotjtja ndërkombëtare” është e nevojshme sepse fëmijët e ndarë kanë lënë komunitetin dhe atdheun e tyre për të hyrë ose për t’u zhvendosur nëpër Europë. Një zgjidhje për situatën e tyre ka mundësi të kërkojë vëmendjen e vendit të tyre të origjinës si dhe të vendit ku banojnë aktualisht. Prandaj janë thelbësore masa mbrotjtëse në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare, të legjislacionit kombëtar dhe të të drejtave të njeriut.

PFNE aktualisht përfshin partnerë nga vendet europiane në vijim: Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Irlanda, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Zvicra.

3. Deklarata e Praktikave të Mira

Deklarata synon të paraqesë një listë të qartë të politikave dhe praktikave të nevojshme për të vënë në zbatim masat që do të sigurojnë përkrahjen dhe mbrotjtjen e të drejtave të fëmijëve të ndarë në Europë. Deklarata mbështetet kryesisht tek Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe dy dokumenta të tjerë: Udhëzimet e UNHCR-së për Politikat dhe Procedurat lidhur me Fëmijët e Pashoqëruar që Kërkojnë Azil, Shkurt 1997, të cilit këtu i referohemi me emrin Udhëzimet e UNHCR-së dhe Pikëpamja mbi Fëmijët Refugjatë e Këshillit Europian mbi Refugjatët dhe të Dëbuarit, Nëntor 1996, të cilit këtu i referohemi me emrin ECRE (Fëmijët).

Gjatë Deklaratës i referohemi të drejtës, politikave dhe udhëzimeve ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me këtë çështje. Këto janë paraqitur të plota në Shtojcën II.

Ky është botimi i tretë i Deklaratës së Praktikave të Mira (DPM) të PFNE-së. Duhet theksuar që ky është një tekst i gjallë që pasqyron ecurinë dinamike të mbrotjtjes së të drejtave të njeriut dhe të çështjeve që prekin në mënyrë të veçantë fëmijët e ndarë. DPM nuk është një listë shteruese e standardeve dhe praktikave të mira, por më tepër një sistem veprimi dhe advokimi që ne mund të vazhdojmë ta zhvillojmë në të ardhmen.

Në këtë këndvështrim, disa çështje bashkëkohore kanë nevojë të trajtohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshme në rishikimet e ardhshme të DPM. Këto çështje që na interesojnë përfshijnë: advokimin për të drejtat e fëmijëve ushtarë, mbrotjtjen e fëmijëve të trafikuar dhe përkrahjen e të drejtave socio-ekonomike të të gjithë fëmijëve të ndarë duke përfshirë të drejtën për të pasur formim profesional dhe mundësi punësimi.

Ju ftojmë të vizitoni faqen tonë të internetit për më shumë materiale që kanë lidhje me këto tema dhe me mbrotjtjen e të drejtave të fëmijëve të ndarë. Gjithashtu mirëpresim vërejtjet dhe komentet tuaja mbi DPM-në me qëllim që ta forcojmë atë dhe përpjekjet tona të përbashkëta në këtë fushë.

4. Shkurtime dhe Akronime të përdorura në referimet

1951 Konventa e Refugjatëve	Konventa e Kombeve të Bashkuara në Lidhje me Statusin e Refugjatëve, 1951
CAT	Konventa Kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese.
CDE	Konventa kundër Diskriminimit në Arsim, 1960
CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundrejt Femrave, 1979
CERD	Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1965
CoE	Këshilli i Europës
CoE 91	Ministrat Rekomandimi Nr. R (91) 11 i Komitetit të Ministrave në Lidhje me Shfrytëzimin Seksual, Pornografinë, Prostitucionin dhe Trafikimin e Fëmijëve dhe të Rinjve
CoE 2000	Ministrat Rekomandimi Nr. R (2000) 11 i Komitetit të Ministrave mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual
CoE Rek. Trainimi i Nëpunësve	Rekomandimi 1309 (1996) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës mbi trainimin e nëpunësve që presin kërkuessit e azilit në pikat kufitare
CoE Rek. Aeroportet	Rekomandimi 1475 (2000) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Mbërritja e kërkuessve të azilit në Aeroportet Europiane
CoE Rek. mbi Dëbimin	Rekomandimi Nr. 1547 (2002) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës mbi Procedurat e Dëbimit në përputhje me të drejtat e njeriut dhe zbatuar nën respektin për sigurinë dhe dinjtetin
CoE të Rinjtë Migrues	Rekomandimi 1596 (2003) i Asamblesë Parlamentare. Situata e të Rinjve Migrues në Europë
CRC	Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1989

CRS	Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë, 1961
Dublin II	Rregullativa (EC) Nr. 343/2003 e Këshillit të BE-së që vendos kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil paraqitur në njërin prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë
ECHR	Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
ECRE (Fëmijët)	Këshilli European për Refugjatët dhe të Dëbuarit: Pikëpamja mbi Fëmijët Refugjatë, 1996
ECRE (Integrimi)	Këshilli European për Refugjatët dhe të Dëbuarit: Pikëpamja mbi Integrimin e Refugjatëve në Europë, dhjetor 2002
EU Dir. Familja	Direktiva 2003/86/EC e Këshillit mbi të drejtën e bashkimit familjar
EU Dir. Pritja	Direktiva 2003/9/EC e Këshillit që parashtron standardet për pritjen e kërkuarve të azilit
EU Rez.	Rezoluta e BE-së mbi të Miturit e Pashoqëruar që janë shtetas të Vendeve të Treta
EU Rez. Minimum	Këshilli i Rezolutës së BE-së mbi garancitë minimale për procedurat e azilit, 1995
Konventa Hagës 1993	Konventa e Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Lidhje me Birësimin në një vend tjetër, 1993
Ministrat e Hagës 1996	Konventa e Hagës mbi Juridiksionin, të Drejtën e Aplikueshme, Njohjen, Përforcimin dhe Bashkëpunimin në Lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve, 1996
ICCPR	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966
ICESCR	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966
ICRMW	Konventa ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migruar dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, 1990

Deklarata e Praktikave të Mira, 2004

ILO C182	Konventa lidhur me Ndalimin dhe Masat e Menjëhershme për Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, ILO C182, 1999
ISS	Shërbimi Social Ndërkombëtar
OSCE	Plani i Veprimit të OSCE-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Takimi Ministror i Mاستriktit, 2003
Protokolli 1 i CRC	Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë e Fëmijëve, 2000
Protokolli 2 i CRC	Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosura, 2000
Protokolli mbi Trafikimin e Personave	Protokolli për Parandalimin, Zhdukjen dhe Dënimin e Trafikimit të Njerëzve, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000
Protokolli mbi Kontrabandim	Protokolli Kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000
RSICC	Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, 1998
UDHR	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948
Udhëzimet e KB mbi DNJ & Trafikimin	Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara nga UNHCHR-ja mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Njerëzor E/2002/68/Add.1, 20 Maj 2002
UNHCHR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNHCR-AP	Axhenda e UNHCR-së për Mbrojtjen, 2002
UNHCR Udhëzimet	Udhëzimet e UNHCR-së mbi Politikat dhe Procedurat që duhen zbatuar lidhur me Fëmijët e Pashoqëruar që Kërkojnë Azil, 1997
UNHCR Manuali	Manuali i UNHCR-së mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit, 1992

B. PARIMET BAZË

Këto janë parimet ku mbështetet Deklarata e Praktikave të Mira dhe duhen mbajtur parasysh në të gjitha stadet e përkujdesjes dhe mbështetjes për fëmijët e ndarë.

** Vini re që shumica e referencave, në shfaqjen e parë, shoqërohen nga një tekst që është vetëm një fragment ose përmbledhje e nenit ose paragrafit përkatës. Përndryshe tekstin ose një *link* që të mundëson leximin e tij mund t'i gjeni në Shtojcën III në fund të publikimit ku janë përmbledhur gjithë referencat. Ata që duan të përdorin nene ose politika për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të ndarë duhet t'i referohen tekstit të plotë të këtyre dokumentave ligjorë. **

1. Interesat më të Mira

Interesat më të Mira të fëmijëve duhet të jenë një element parësor në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët.

* CRC, Neni 3(1): Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën... interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

* ECRE (Fëmijët), parag. 4

* ICCPR, Neni 24(1): Çdo fëmijë, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtën e masave mbrojtëse që ia kërkon vetë statusi i tij si i mitur, nga ana e familjes, shoqërisë dhe Shtetit.

* ICESCR, Neni 10(3): Masa të posaçme mbrojtjeje duhet të merren në favor të të gjithë fëmijëve pa kurrfarë diskriminimi.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag.1.5

* Manuali i UNHCR-së, parag. 14

2. Mosdiskriminimi

Fëmijët e ndarë përfitojnë të njëjtin trajtim dhe të njëjtat të drejta me fëmijët vendas apo ata me banim në vend. Ata duhet të trajtohen në radhë të parë dhe mbi të gjitha si fëmijë. Të gjitha vlerësimet mbi statusin e tyre të emigrantit duhet të jenë dytësore.

* CRC, Neni 2: Të drejtat e kësaj Konvente zbatohen për çdo fëmijë, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij.

* CRC, Neni 22(1): Fëmijëve të ndarë refugjatë dhe kërkues të azilit u jepet e drejta për mbrojtje dhe asistencë për t'u lejuar atyre të gëzojnë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe dokumentat e tjera ligjore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

* CEDAW: Kjo Konventë përcakton masat për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave.

* CERD

* ECHR, Neni 14: Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

* ECRE (Fëmijët), parag. 5-7

* ICCPR, Neni 24(1)

* ICESCR, Neni 10(3)

* ICRMW, Neni 18(1): Punëtorët migrues dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë të drejta të barabarta me qytetarët e një Shteti përpara gjykatave.

* Protokoll i mbi Trafikimin, Neni 14(2): Masat duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që personat të mos bëhen objekt diskriminimi për arsyen se janë viktime të një trafiku qeniesh njerëzore.

* Protokoll kundër kontrabandimit, Neni 19(2): Masat duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që personat të mos bëhen objekt diskriminimi për arsyen se janë viktime të akteve të përmendura në nenin 6 të këtij Protokoll.

3. E Drejta për Pjesëmarrje

Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijëve të ndarë duhen kërkuar dhe marrë në konsideratë sa herë që duhet të merren vendime që kanë të bëjnë me ta. Duhet të merren masa për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në përputhje me moshën dhe shkallën e tyre të pjekurisë.

* CRC, Neni 12: Pikëpamjeve të fëmijëve duhet t'u jepet rëndësia e duhur, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, dhe fëmijët duhet të kenë mundësinë të dëgjoen për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta.

* ECRE (Fëmijët), parag. 25 & 26

* UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 6(2): Shtetet, UNHCR dhe partnerët e tyre duhet të marrin masa për të garantuar që fëmijët refugjatë të marrin pjesë në mënyrë të drejtë në proceset e vendimmarrjes, në të gjitha fushat e jetës së refugjatit, si dhe në vënien në zbatim të këtyre vendimeve.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.14 - 5.15

* Manuali i UNHCR-së, parag. 41

4. Respekti për Identitetin Kulturor

Është thelbësore që fëmijët e ndarë të jenë në gjendje të ruajnë gjuhën e tyre të nënës dhe lidhjet me kulturën dhe fenë e tyre. Kujdesi për fëmijën, kujdesi shëndetësor dhe arsimimi që u sigurohet atyre duhet të pasqyrojnë nevojat e tyre kulturore. Duhet bërë kujdes që të mos kenë vazhdimësi ato aspekte të traditave kulturore që janë të dëmshme dhe diskriminuese ndaj fëmijës. Ruajtja e kulturës dhe gjuhës është gjithashtu e rëndësishme në rastin e kthimit të fëmijës në atdheun e tij.

- * CRC, Neni 8: Fëmijët kanë të drejtën të ruajnë ose rivendosin elemente thelbësore të identitetit të tyre.
- * CRC, Neni 24: Fëmijët kanë të drejtën e standardeve më të larta të arritshme të shëndetit dhe lehtësirave për trajtim dhe riabilitim.
- * CRC, Neni 30: Fëmijët që u përkasin pakicave etnike, fetare apo gjuhësore kanë të drejtën të kenë kulturën e tyre, të praktikojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e tyre.
- * ECRE (Fëmijët), parag. 39
- * ICCPR, Neni 27: Në Shtetet ku ekzistojnë pakicat etnike, fetare apo gjuhësore, personave që u përkasin këtyre pakicave nuk mund t'u mohohet e drejta për të predikuar dhe praktikuar fenë e tyre ose për të përdorur gjuhën e tyre.
- * ICRMW, Neni 12(1): Punëtorët migrues dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.
- * ICRMW, Neni 31: Shtetet sigurojnë respektin për identitetin kulturor të punëtorëve migrues dhe të familjeve të tyre dhe nuk i ndalojnë ata të mbajnë lidhje kulturore me Shtetin tyre të origjinës.

5. Interpretimi

Fëmijëve të ndarë duhet t'u sigurohen përkthyes të trainuar në mënyrë të përshtatshme, të cilët flasin gjuhën e tyre të preferuar, sa herë që intervistohen ose kanë nevojë për akses në shërbimet ose procedurat ligjore.

- * CRC, Neni 12
- * CRC, Neni 13: Fëmijët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacion.
- * ICCPR, Neni 19: Çdokush ka të drejtën të ketë opinionet e tij pa ndërhyrje. Çdokush ka të drejtën e lirisë së të shprehurit.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.13

6. Fshehtësia

Duhet bërë kujdes që të mos përhapet informacion për një fëmijë të ndarë që mund të rrezikojë anëtarët e familjes së fëmijës në atdheun e tij. Leja e fëmijëve të ndarë duhet të kërkohe në një mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre para se informacione delikate t'u jepen organizatave ose individëve të tjerë. Këto informacione nuk duhet të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë.

- * CRC, Neni 16: Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga ndërhyrja arbitrare ose e paligjshme në jetën e tyre private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tyre.
- * ECHR, Neni 8: Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.
- * EU Rez., Neni 3(1): Informacioni mbi identitetin dhe situatën e të miturit mund të merret me mënyra të ndryshme, veçanërisht nëpërmjet një interviste të përshtatshme që

duhet marrë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në një mënyrë të përshtatshme me moshën e tij. Në kërkimin, mbledhjen, përcjelljen dhe ruajtjen e informacionit të marrë duhet të përdoret kujdes dhe fshehtësi e veçantë në mënyrë që të mbrohen si i mituri ashtu edhe anëtarët e familjes së tij.

* ICCPR, Neni 17: Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, familjen, banesën ose korrespondencën e tij dhe as sulmeve të paligjshme ndaj nderit dhe reputacionit të tij.

* ICRMW, Neni 14: Asnjë punëtor migrues ose anëtar i familjes së tij nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familjen e tij, në vendbanimin e tij, në korrespondencën ose në mënyrat e tjera të komunikimit.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.16 & 5.17

7. Informacioni

Fëmijëve të ndarë duhet t'u sigurohet informacion i arritshëm rreth, për shembull, të drejtave të tyre, shërbimeve në dispozicion, procedurave të azilit, procedurave të kërkimit të familjes dhe situatës në vendin e tyre të origjinës.

* CRC, Neni 13

* CRC, Neni 17: Shtetet duhet të garantojnë që fëmijët të marrin informacion nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

* CRC, Neni 22(2): Shtetet bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare në masat për kërkimin e familjeve.

* ECRE (Fëmijët), parag. 31

* ICRMW, Neni 33(1)(b): Punëtorët migrues dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë të drejtën të njoftohen për sa i përket kushteve të hyrjes dhe të drejtave dhe detyrimeve të tyre.

8. Bashkëpunimi midis Organizatave

Organizatave, departamentet qeveritare dhe profesionistët e përfshirë në sigurimin e shërbimeve për fëmijët e ndarë duhet të bashkëpunojnë për të garantuar forcimin dhe mbrojtjen e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve të ndarë. Një përjasje gjithëpërfshirëse duhet të adoptohet në përpjekjet për të plotësuar nevojat e ndërthurura të fëmijëve të ndarë.

* CRC, Neni 22(2)

* EU Rez., Neni 5(3c&d): Autoritetet duhet të bashkëpunojnë, me qëllim kthimin e të miturit, me organizata ndërkombëtare si UNCHR-ja dhe UNICEF-i dhe, sipas rastit, me organizata joqeveritare për të siguruar vënien në dispozicion të një infrastrukture pritjeje dhe përkujdesjeje në vendin ku i mituri do të kthehet.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 12

9. Formimi i Personelit

Personat që punojnë me fëmijët e ndarë duhet të marrin një formim të përshtatshëm mbi nevojat dhe të drejtat e fëmijëve të ndarë. Personeli i emigrimit ose i policisë kufitare duhet të marrë trainim për kryerjen e intervistave të përshtatura për fëmijët.

* CRC, Neni 3(3): Shtetet marrin masa që institucionet dhe shërbimet që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara, veçanërisht në fushën e numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

* CoE Rec. Formimi i Personelit, parag. 3 & 4

* EU Dir. Pritja, Neni 19(4): Personat që punojnë me të mitur të pashoqëruar duhet të kenë ose duhet të marrin formimin e duhur lidhur me nevojat e tyre dhe duhet të kufizohen nga parimi i ruajtjes së fshehtësisë, siç parashikon e drejta kombëtare, për sa i përket çdo informacioni të marrë gjatë punës së tyre.

* EU Rez., Neni 4(5): Intervista duhet të kryhet nga agjentë me përvojën apo formimin e duhur. Rëndësia e një formimi të përshtatshëm për agjentët që intervistojnë të miturit e pashoqëruar që kërkojnë azil duhet të njihet siç i takon.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 11

10. Jetëgjatësia

Vendimet që merren në lidhje me fëmijët e ndarë duhet të marrin parasysh, sa më shumë që të jetë e mundur, interesat më të mira dhe mirëqenien e fëmijës në një afat të gjatë kohor.

* CRC, Neni 3 (1)

* CRC, Neni 22 (1)

* CRC, Neni 22(2)

* EU Rez., Neni 5: Nëse një të mituri nuk i lejohet të zgjasë qëndrimin e tij, Shteti Anëtar përkatës mund të rikthejë të miturin në vendin e tij të origjinës ose në një vend të tretë që është i gatshëm ta presë atë, vetëm nëse vërtetohet që, në mbërritjen atje, të miturit do t'i sigurohen pritja dhe përkujdesja e duhur.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 9

* Manuali i UNHCR-së, parag. 214

11. Koha

Të gjitha vendimet që kanë lidhje me fëmijët e ndarë duhet të merren në momentin e përshtatshëm dhe duke marrë parasysh perceptimin që ka fëmija për kohën.

* CRC Neni 3(1)

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 8.1 & 8.5

C. PRAKTIKAT E MIRA

Paragrafi i mëposhtëm përcakton praktikat e mira që duhen ndjekur lidhur me fëmijët e ndarë që nga momenti i mbërritjes deri në marrjen e vendimeve afatgjata mbi të ardhmen e tyre.

1. Hyrja në territor

Fëmijëve të ndarë që kërkojnë mbrojtje nuk duhet asnjëherë t'u refuzohet hyrja apo të rikthehen në pikën e hyrjes. Ata nuk duhet të arrestohen asnjëherë për arsye emigrimi. Gjithashtu nuk duhet t'u nënshtrohen intervistave të detajuara nga autoritetet e emigrimit në pikën e hyrjes (shih paragrafin C. 6).

- * CRC, Neni 6(1): Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
- * CRC, Neni 37(b): Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmijë duhet të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe duhet bërë veçmas nga të rriturit.
- * 1951 Konventa e Refugjatëve:
Neni 31: Shtetet nuk duhet të penalizojnë personat që hyjnë ose ndodhen në mënyrë të paligjshme në një vend nëse ata kanë ardhur nga një territor ku ishin objekt përndjekjeje sipas kuptimit të parashikuar në Nenin 1.
Neni 33: Shtetet nuk duhet të kthejnë një refugjat në një vend ku jeta ose liria e tij janë të rrezikuara sipas kuptimit të parashikuar në Nenin 1.
- * CAT, Neni 3. Asnjë shtet nuk i kthen personat në një vend ku rrezikojnë t'u nënshtrohen torturave.
- * Dublin II Neni 3(1): Shtetet Anëtare shqyrtojnë kërkesën për azil të çdo shtetasi të një vendi të tretë që e bën këtë kërkesë në kufi apo brenda territorit të Shtetit në fjalë.
- * ECHR, Neni 2(1): E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.
- * ECHR, Neni 3. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.
- * ECRE (Fëmijët), parag. 14 & 15
- * EU Rez. Minimum, parag. 1: Procedurat pajtohen tërësisht me Nenin 1 të Konventës së v. 1951 që ka të bëjë me përkufizimin e nocionit të refugjatit dhe me Nenin 33 të saj që lidhet me parimin e 'mos-shtypjes'.
- * ICCPR, Neni 6(1): E drejta për të jetuar lind me njeriun. Kjo e drejtë mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i hiqet jeta në mënyrë arbitrare.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 4.1 & 4.2

2. Fëmijët Viktima të Trafikimit

Trafikimi i Fëmijëve për qëllime prostitucioni, prodhimi materialesh pornografike me fëmijë dhe formash të tjera shfrytëzimi është një problem serioz në Europë. Shtetet duhet të marrin masa kundërvepruese për të parandaluar dhe frenuar trafikimin duke ndarë informacionet mbi trafikimin me shtetet e tjera dhe duhet të garantojnë që punonjësit e emigracionit dhe policia kufitare janë vigjilentë lidhur me këtë problem.

Fëmijët shfrytëzohen si nga ata që i trafikojnë ashtu edhe nga ata që përdorin shërbimet e tyre në vendin ku mbërrijnë.

Mënyra e trajtimit të fëmijëve të trafikuar nga punonjësit e emigracionit, policia, punonjësit socialë dhe profesionistë të tjerë duhet të udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së fëmijës i cili duhet të mbizotërojë ndaj kontrollit të emigracionit apo parandalimit të krimit.

Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijëve viktima të trafikimit duhet të kërkohen dhe të merren parasysh kurdo që të merren vendime lidhur me ta, me qëllimin gjithashtu për të ndihmuar reabilitimin dhe autonominë e tyre.

*CRC, Neni 34: Shtetet duhet të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.

*CRC, Neni 35: Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar rrëmbimin, tregtinë ose trafikimin e fëmijëve për çdo qëllim ose të çdo forme.

*CRC, Neni 36: Shtetet duhet të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit të dëmshme për mirëqenien e tyre.

*CRC, Neni 37

*Protokolli 1 i CRC, Neni 3: Kërkon që shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe trafikimi i fëmijëve për çdo qëllim (transplant organesh, birësim, prostitucion, punë të detyruar) të mbulohen nga e drejta penale.

*Protokolli 1 i CRC, Neni 8(1): Shtetet duhet të adoptojnë masa të përshtatshme për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijëve viktima të shfrytëzimit seksual dhe trafikimit.

*CEDAW, Neni 6: Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura, përfshirë këtu dispozitat ligjore, për të shtypur të gjitha format e trafikimit të grave dhe shfrytëzimin seksual të grave (dhe vajzave).

*CoE Ministrat 91

*CoE Ministrat 2000

*CoE Të Rinjtë Migrues, parag. 8

*Këshilli i BE: Veprime të përbashkëta për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve, 24 shkurt 1997

*Këshilli i BE: Deklarata e Brukselit mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, maj 2003: parag. 9, 12, 13

*ECHR, Neni 4: Askush nuk mund të mbahet në skllavëri as në robëri apo t'i nënshtrohet punës së detyruar.

*ICCPR, Neni 8: Askush nuk mund të mbahet në skllavëri as në robëri apo të shtrengohet të kryejë punë të detyruar.

*ICESCR, Neni 10(3): Fëmijët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe social.

* ILO C182, Neni 3: Termi “format më të egra të punës së fëmijës” përfshin shitjen dhe trafikimin e fëmijëve.

* OSCE

* Protokoll mbi Trafikimin e Njerëzve,

Neni 3(a): Trafikimi i njerëzve nënkupton rekrutimin, transportin, transferimin, strehimin e fshehtë apo marrjen e njerëzve nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, nëpërmjet rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërisë, shfrytëzimit të pushtetit ose të një pozite dobësie ose nëpërmjet dhënies dhe marrjes së pagesave apo përfitimeve të tjera për të bindur një person që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, të paktën, shfrytëzimin e prostituimit të tjerëve ose të formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punën dhe shërbimet e detyruara, skllavërinë apo punët e ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.

* Neni 3(c): Rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi i fshehtë ose marrja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi duhet të konsiderohet trafik njerëzor edhe nëse kjo nuk përfshin ndonjë nga mënyrat e përshkruara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

* Neni 6: Shtetet duhet të sigurojnë asistencë dhe ndihmë për viktimat e trafikimit.

* Neni 7: Çdo Shtet Palë merr parasysh adoptimin e masave të nevojshme për t'u lejuar viktimave të trafikimit të qëndrojnë në territorin e tij, përkohësisht ose përgjithnjë, kur rasti e kërkon.

* Neni 9: Shtetet duhet të marrin masa të ndryshme për të parandaluar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat.

* Neni 10: Autoritetet gjyqësore, ato të emigracionit dhe autoritete të tjera bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacion në lidhje me trafikimin. Shtetet sigurojnë dhe forcojnë formimin e autoriteteve përkatëse.

* Neni 14(2)

* Protokoll kundër Kontrabandimit, Neni 19

* Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut & Trafikimin, Udhëzimi 8

* UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 2(2): Shtetet duhet të garantojnë që proceset e tyre të azilit janë të hapura për të marrë kërkesat nga persona të trafikuar, sidomos nga gra dhe vajza.

3. Fëmijët e Ndarë Migrues

Disa fëmijë të ndarë udhëtojnë të vetëm si emigrantë për t'i shpëtuar varfërisë, mungesave dhe vuajtjeve. Nëse ndalohen nga autoritetet, fëmijët e ndarë migrues nuk duhet të dëbohen nga ai vend pa një verifikim të hollësishëm të situatës në vendin e tyre të origjinës. Atyre duhet t'u jepet e drejta të bëjnë një kërkesë për azil dhe/ose një kërkesë për qëndrim. Të gjithë fëmijët e ndarë migrues duhet të kenë mundësi të shfrytëzojnë shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, shërbimet e arsimit dhe shërbimet shëndetësore.

* CRC Art 2

* CoE të Rinjtë Migrues, parag. 6

* ICRMW: Kjo Konventë vendos të drejtat e të gjithë punëtorëve migrues dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

* Protokoll kundër Kontrabandimit, Neni 19(2)

4. Identifikimi

Në pikat e hyrjes, autoritetet e emigracionit duhet të vendosin procedura për të identifikuar fëmijët e ndarë dhe për t'i drejtuar ata tek autoritetet kompetente për mbrojtjen e fëmijës. Kur një i rritur shoqëron fëmijët, është e nevojshme të verifikohet natyra e lidhjes midis fëmijës dhe të rriturit. Meqenëse shumë fëmijë të ndarë hyjnë në një vend pa u identifikuar si “të ndarë” në pikat e hyrjes, organizatat dhe profesionistët duhet të shkëmbejnë informacionet që kanë në mënyrë që të identifikohen fëmijët e ndarë dhe të garantohet marrja prej tyre e mbrojtjes së duhur.

Disa fëmijë mbeten të ndarë pas hyrjes në një vend (shkatërrim i situatës familjare, largim i kujdestarit etj.). Autoritetet e emigracionit dhe të përcaktimit të statusit të refugjatit duhet të garantojnë që çdo ndryshim i statusit që rrjedh nga kjo ndarje do të pasqyrohet në procedurat e tyre.

* CRC, Neni 8

* EU Rez., Neni 3(1)

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.1 - 5.3 & Shtojca II

5. Kërkimi i Familjeve dhe Kontaktet

Kërkimi i prindërve dhe i familjes së fëmijës duhet të ndërmerret sa më shpejt që të jetë e mundur, por kjo duhet bërë vetëm atëherë kur nuk rrezikon fëmijën ose anëtarët e familjes së fëmijës në vendin e origjinës. Kërkimi duhet të ndërmerret duke ruajtur fshehtësinë. Shtetet dhe organizata të tjera që ndërmarrin kërkimin duhet të bashkëpunojnë me agjensitë e Kombeve të Bashkuara, agjensinë Qëndrore të Kërkimit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Shërbimet Sociale Ndërkombëtare. Fëmijët e ndarë duhet të informohen siç duhet dhe të konsultohen lidhur me këtë proces dhe pikëpamjet e tyre duhet të merren parasysh. Kur rasti e lejon, personat përgjegjës për mirëqenien e fëmijës duhet të lehtësojnë komunikimin e rregullt midis fëmijës dhe familjes së tij ose të saj.

* CRC, Neni 9(3): Fëmijët që janë të ndarë nga prindërit e tyre kanë të drejtën të mbajnë kontakte me prindërit e tyre.

* CRC, Neni 10(1): Kërkesat për bashkim familjar trajtohen “në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi”

* CRC, Neni 10(2): Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie të rregullta me të dy prindërit e tij.

* CRC, Neni 22(2)

* ECHR, Neni 8

* ECRE (Fëmijët), parag. 32

* EU Dir. Pritja, Neni 19(3): Shtetet Anëtare, duke mbrojtur interesat më të mira të të miturve të pashoqëruar, duhet të përpiqen të gjejnë, sa më shpejt që të jetë e mundur, anëtarët e familjes së tyre. Në rastet kur të miturve apo të afërmit e tyre u rrezikohet jeta ose paprekshmëria, duhet bërë e mundur që grumbullimi, shqyrtimi dhe qarkullimi i informa-

cionit të ndërmerren mbi baza fshehtësie, për të shmangur vënien në rrezik të sigurisë së tyre.

* EU Rez., Neni 3(3): Shtetet Anëtare duhet të bëjnë çdo përpjekje për të gjetur anëtarët e familjeve të të miturve të pashoqëruar, ose për të identifikuar vendin e tyre të banimit, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor dhe pa paragjykuar karakterin e ligshëm të çdo kërkesë për qëndrim. Të miturit e pashoqëruar gjithashtu mund të nxiten dhe të ndihmohen që të kontaktojnë Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, organizatat kombëtare të Kryqit të Kuq ose organizata të tjera për kërkimin e anëtarëve të familjeve të tyre. Fshehtësia duhet ruajtur në masën e duhur në mënyrë që të mbrohen si i mituri ashtu edhe anëtarët e familjes së tij.

* ICCPR, Neni 23(1): Familja ka të drejtën e mbrojtjes nga shteti.

* ICRMW, Neni 44(1): Shtetet marrin masa për të siguruar mbrojtjen e unitetit të familjeve të punëtorëve migrues.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.17

* Manuali i UNHCR-së, parag. 218

6. Caktimi i një Kujdestari apo Këshilltari

Sapo një fëmijë i ndarë të identifikohet, duhet të caktohet – me një perspektivë afatgjatë – një kujdestar ose këshilltar i pavarur për të këshilluar dhe mbrojtur fëmijën e ndarë. Pavarësisht nga statusi ligjor i këtij personi (p.sh. kujdestar ligjor, punëtor i një OJQ-je) përgjegjësitë e tij duhet të jenë si më poshtë:

- të garantojë që të gjitha vendimet e marra janë në interesin më të mirë të fëmijës
- të garantojë që fëmija i ndarë ka përkujdesjen, strehimin, arsimimin, mbështetjen gjuhësore dhe kujdesin shëndetësor të duhur.
- të garantojë që fëmija ka një përfaqësim ligjor të përshtatshëm gjatë diskutimeve mbi statusin e tij të emigracionit ose kërkesën për azil
- të konsultohet me fëmijën dhe ta këshillojë atë
- të japë ndihmesën e tij për një zgjidhje të qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës
- të sigurojë një lidhje midis fëmijës dhe organizatave të ndryshme që mund të sigurojnë shërbime për fëmijën
- të advokojë në emër të fëmijës kur të jetë e nevojshme
- të shqyrtojë, bashkë me fëmijën, mundësinë e kërimit të familjes dhe bashkimit familjar.
- të ndihmojë fëmijën që të qëndrojë në kontakt me familjen e tij/saj.

Për të garantuar mbrojtjen e nevojshme për fëmijët e ndarë, caktimi i kujdestarëve/këshilltarëve duhet të bëhet brenda një muaji që nga informimi i autoriteteve përkatëse për fëmijën.

Personat që mbajnë këto përgjegjësi mund të përzgjidhen nga një sërë mjedisesh të specializuara. Megjithatë, për të kryer rolin e tyre me efektivitet, këshilltarët ose kujdestarët duhet të kenë njohuri të përshtatshme lidhur me kujdesin për fëmijën dhe duhet të kuptojnë nevojat e veçanta dhe kulturore të fëmijëve të ndarë. Ata duhet të trainohen dhe të marrin mbështetje profesionale si dhe t'i nënshtrohen kontrollit të referencave nga policia.

* CRC, Neni 12

* CRC, Neni 18(2): Shtetet u japin ndihmën e duhur përfaqësuesve ligjorë në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës.

- * CRC, Neni 20(1): Fëmijët të cilëve u mohohet ambjenti i tyre familjar kanë të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme.
- * CRC, Neni 20(3): Në përkujdesjen që u sigurohet fëmijëve të cilëve u është mohuar familja duhet marrë parasysh origjina e tyre etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.
- * CoE të Rinjtë Migrues, parag. 4,vi.
- * ECRE (Fëmijët), parag. 16-18
- * EU Dir. Pritja, Neni 19(1): Shtetet Anëtare marrin sa më shpejt masa për të garantuar përfaqësimin e nevojshëm të të miturve të pashoqëruar nga kujdestarë ligjorë, apo nga një organizatë që përgjigjet për kujdesin dhe mirëqenien e të miturve ose çdo përfaqësim tjetër të përshtatshëm. Autoritetet përkatëse duhet të kryejnë vlerësime rregullisht.
- * EU Rez., Neni 3(4&5): Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë sa më shpejt kujdestari ligjor apo përfaqësim nga një organizatë që është përgjegjëse për kujdesin dhe mirëqenien e të miturve ose përfaqësim tjetër të përshtatshëm. Kujdestari duhet të garantojë plotësimin e nevojave (p.sh. ligjore, shoqërore, mjekësore ose psikologjike) të të miturit.
- * Konventa e Hagës, 1993
- * Konventa e Hagës, 1996, Neni 3: Shtetet ku fëmijët e ndarë janë vendosur me banim mund të marrin masa mbrojtjeje duke përfshirë dhënien në kujdestari apo institucione të ngjashme.
- * Konventa e Hagës, 1996, Neni 6: Kjo Konventë zbatohet për fëmijët e ndarë që janë refugjatë ose janë zhvendosur jashtë atdheut për shkak të trazirave që ndodhin në vendin e tyre.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.7
- * Manuali i UNHCR-së, parag. 214
- * UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 1(9): Shtetet, UNHCR-ja, OJQ-të dhe partnerë të tjerë duhet të punojnë për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve të ndarë, duke përfshirë vendosjen e tyre të përkohshme në familje kujdestare apo caktimin e kujdestarëve shtetërorë ose jo-shtetërorë si dhe monitorimin e këtyre masave.

7. Regjistrimi dhe Pajisja me Dokumenta

Regjistrimi dhe pajisja me dokumenta janë thelbësore për mbrojtjen e interesave afatgjata të fëmijëve të ndarë. Kjo duhet të kryhet nëpërmjet një procedure intervistimi “me dy kohë”. Punonjësit e emigracionit dhe policisë kufitare duhet të mjaftohen me intervistat për mbledhjen e informacionit kryesor rreth identitetit të fëmijës. Intervistat me autoritetet e emigracionit duhet të zhvillohen gjithnjë në praninë e një këshilltari ligjor, një kujdestari ose një personi tjetër që ka mandat.

E kaluara e plotë shoqërore (shih Shtojcën I) duhet të merret nga autoriteti kompetent për mirëqenien e fëmijëve ose ndonjë organizatë tjetër e caktuar e cila ka për detyrë të përkujdeset për fëmijën. Të gjithë ata që intervistojnë fëmijët e ndarë duhet të kenë trainim dhe njohuri të përshtatshme në intervistimin e këtyre fëmijëve.

- * CRC, Neni 8
- * EU Rez., Neni 3(1)
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.6 & 5.8 - 5.10

8. Vlerësimi i Moshës

Vlerësimi i moshës përfshin faktorë fizikë, të zhvillimit, psikologjikë dhe kulturorë. Nëse mendohet se vlerësimi i moshës është i nevojshëm, ai duhet të kryhet nga profesionistë të pavarur të cilët kanë një njohje të mirë të mjedisit etnik/kulturor të fëmijës. Vlerësimet nuk duhet të jenë të detyruara ose të papërshtatshme nga ana kulturore. Kujdes i veçantë duhet të tregohet që ato të jenë të përshtatshme për gjininë.

Në raste dyshimi, personi që deklaron se është nën 18 vjeç do të trajtohet përkohësisht si i tillë. Është e rëndësishme të vihet re që vlerësimi i moshës nuk është një shkencë e saktë dhe ekziston një mundësi gabimi e konsiderueshme. Gjatë kryerjes së një përcaktimi të moshës, fëmijët e ndarë duhet të mund të përfitojnë nga parimi i mëdyshjes.

* 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 31: Nuk duhet të jepen dënime për azilkërkuesit të cilët hyjnë në mënyrë të paligjshme në një vend nëse ata janë në gjendje të paraqesin arsye të vlefshme për hyrjen e tyre të paligjshme.

* ECRE (Fëmijët), parag. 9

* EU Rez., Neni 4(3): Vlerësimi i moshës duhet të bëhet objektivisht. Për qëllime të tilla, Shtetet Anëtare mund të zhvillojnë një test mjekësor moshe të kryer nga një personel mjekësor i kualifikuar, me miratimin e të miturit ose të një përfaqësuesi të rritur apo të një institucioni të caktuar posaçërisht.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.11

* Manuali i UNHCR-së, parag. 196-197

9. Liria nga Arresti

Fëmijët e ndarë nuk duhet të mbahen kurrë nën arrest për arsye që kanë të bëjnë me statusin e tyre të emigrantit. Kjo përfshin arrestin në kufi, për shembull në zonat ndërkombëtare, në qendrat e arrestit, në rajonet e policisë, në burgje apo në çdo qendër tjetër arresti për të rinj.

* CRC, Neni 37(a): Fëmijët nuk duhet t'i nënshtrohen trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës.

* CRC, Neni 37(b)

* ECHR, Neni 3

* ECHR, Neni 5: Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë.

* ECRE (Fëmijët), parag. 20

* EU Rez., Neni 2(3): Fëmijët e pashoqëruar që duhet të qëndrojnë në kufi deri kur të merret një vendim për pranimin apo kthimin e tyre mbrapsht, duhet të marrin çdo mbështetje materiale dhe çdo përkujdesje të nevojshme.

* ICCPR, Neni 7: Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit dhe dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

* ICCPR, Neni 9: Askush nuk duhet t'i nënshtrohet arrestit apo ndalimit arbitrar.

* ICRMW, Neni 16(4): Punëtorët migrues dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund të jenë objekt, në mënyrë individuale ose kolektive, i një arrestimi ose i një burgimi arbitrar.

- * Rregullat e Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të Rinjve të Cilëve u është Hequr Liria
- * UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 1(9)
- * Udhëzimet e UNHCR-së parag. 7.6 & 7.7

10. E Drejta për Pjesëmarrje

Pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijëve të ndarë duhen kërkuar dhe marrë në konsideratë sa herë që duhet të merren vendime që kanë të bëjnë me ta. Duhet të merren masa për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në përputhje me moshën dhe shkallën e tyre të pjekurisë. Fëmijët e ndarë kanë të drejtën të dëgjohen drejtpërdrejt ose nëpërmjet një përfaqësuesi apo kujdestari/këshilltari ligjor në çdo procedurë ligjore.

Fëmijëve të ndarë duhet t'u jepet mundësia dhe nxitja për të shprehur pikëpamjet, shqetësimet dhe ankesat në lidhje me përkujdesjen dhe kujdestarinë, arsimimin, shërbimet shëndetësore dhe përfaqësimin ligjor të tyre.

- * CRC, Neni 12
- * CRC, Neni 25: Fëmijët që janë vendosur nën kujdesin e institucioneve të ndryshme kanë të drejtën e një ekzaminimi periodik të rrethanave të tyre.
- * ECRE (Fëmijët) parag. 25 & 26
- * UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 6(2)
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.14 & 5.15

11. Kujdesi i Përkohshëm – Shëndeti, Edukimi dhe Formimi

11.1 Kujdesi i Përkohshëm

Fëmijët e ndarë duhet të vendosen në struktura të përshtatshme sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes ose identifikimit të tyre. Autoritetet përgjegjëse për kujdesin duhet të bëjnë një vlerësim të kujdesshëm të nevojave të tyre dhe të kufizojnë në maksimum ndryshimet. Duhet të kryhet rregullisht një kontroll i masave të kujdesit. Vëllezërit dhe motrat duhet të mbahen bashkë, nëse është në interesin e fëmijës. Kur fëmijët jetojnë ose janë vendosur tek të afërmit e tyre, duhet të vlerësohet aftësia e këtyre të afërmeve për të siguruar përkujdesje të përshtatshme dhe ata duhet t'i nënshtrohen gjithashtu kontrolleve të policisë. Fëmijët e ndarë mbi 16 vjeç nuk duhet të trajtohen si të rritur "de facto" dhe të vendosen për të jetuar vetëm, pa ndihmë nga të rritur, në konvikte apo qendra pritjeje.

Qoftë nëse vendosen nën një kujdes familjar, qoftë në qendra pritjeje, fëmijët e ndarë duhet të kenë kujdesin e profesionistëve të përshtatshëm të cilët kuptojnë nevojat e tyre kulturore, gjuhësore dhe fetare dhe njohin çështjet që ndikojnë tek fëmijët e ndarë migrues dhe tek azilkërkuesit. Ata që punojnë me fëmijë të ndarë duhet të jenë të vetëdijshëm që fëmijët kanë të drejtën e jetës private dhe të drejtën për një marrëdhënie mirëbesimi me kujdestarin dhe/ose përfaqësuesin e tyre ligjor si dhe me çdo advokues tjetër.

Punonjësit e përkujdesjes duhet ta ndihmojnë fëmijën të krijojë lidhje me bashkësinë e tij etnike sa herë që të jetë e mundur.

Fëmijët viktime të trafikimit nuk duhet të mbahen në arrest nga shërbimet e emigracionit me qëllimin për t'i mbrojtur nga trafikuesit e tyre. Masa të tjera mbrojtëse, si p.sh. shtëpi të sigurta, duhet të zhvillohen, në bashkëpunim me autoritetet e mbrojtjes së fëmijës.

Për të vendosur sigurinë, punonjësit e përkujdesjes në qendrat e pritjeve dhe në vatrën e banimit duhet të ndërhyjnë për problemin e trafikimit të fëmijëve për qëllime prostitucioni ose formash të tjera shfrytëzimi.

* CRC, Nenet 3(3) & 13

* CRC, Neni 14: Fëmijët kanë të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

* CRC, Neni 15: Fëmijët kanë të drejtën e lirisë së grumbullimit.

* CRC, Neni 16

* CRC, Neni 19: Shtetet marrin të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, mospërfilljes, keqtrajtimit ose shfrytëzimit

* CRC, Nenet 20(1), 20(3) & Neni 25

* CRC, Neni 26: Fëmijët kanë të drejtë të përfitojnë nga përkrahja shoqërore dhe sigurimet shoqërore.

* CRC, Neni 27: Fëmijët kanë të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tyre fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

* CRC, Nenet 30, 34, 35 & 36

* ECHR, Neni 9: Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si edhe lirinë për të shfaqur

fenë e tij ose bindjet e tij individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve.

* ECHR, Neni 10: Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.

* ECHR, Neni 11: Çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerë.

* ECRE (Fëmijët), parag. 12 & 19

* EU Dir. Pritja, Neni 19(2): Brenda mundësive, vëllezërit dhe motrat duhet të mbahen bashkë, duke marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës si dhe moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij ose të saj. Ndryshimet e vendbanimit duhet të kufizohen sa më shumë.

* EU Rez. Nenet 3(2,4&5) dhe 4(4): Pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor, të miturve të pashoqëruar duhet t'u jepet e drejta për të pasur mbrojtjen dhe kujdesin themelor të nevojshëm në përputhje me çka parashikon legjislacioni kombëtar. Gjatë procedurave të azilit, Shtetet Anëtare normalisht duhet t'i vendosin të miturit e pashoqëruar me të afërm të rritur, me një familje kujdestare, në qendra pritjeje të përshtatura për të miturit ose në strehime të tjera me kushte të përshtatshme për të mitur.

* ICCPR, Neni 18(1): Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

* ICCPR, Neni 19

* ICCPR, Neni 21: Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit me të tjerë.

* ICCPR, Neni 22: Çdokush ka të drejtën e lirisë së organizimit me të tjerë.

* ICCPR, Neni 24(1)

* ICESCR, Neni 9: Shtetet Palë në këtë Pakt njohin të drejtën e çdo personi për sigurinë shoqërore, përfshirë sigurimet shoqërore.

* ICESCR, Neni 11(1): Shtetet Palë në këtë Pakt njohin të drejtën e çdo personi për një nivel jetese të mjaftueshëm për vete dhe për familjen e tij, përfshirë një ushqim, një veshje dhe një banesë të mjaftueshme, si edhe për një përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 7.1 -7.5

11.2 Shëndeti

Fëmijët e ndarë duhet të kenë mundësi të përdorin shërbimet shëndetësore po aq sa fëmijët vendas. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave të tyre shëndetësore që rrjedhin prej keqtrajtimit të mëparshëm fizik, shëndetit të keq, aftësive të kufizuara dhe prej impaktit psikologjik të dhunës, traumës dhe humbjes si dhe efektit të racizmit dhe ksenofobisë që mund të përjetohen jashtë vendlindjes. Për shumë fëmijë të ndarë kujdesi i një psikologu është thelbësor në shërimin e tyre.

* CRC, Neni 23: Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të gëzojnë një jetë të plotë dhe dinjitoze si dhe të drejtën e një kujdesi të posaçëm.

* CRC, Neni 24

* CRC, Neni 39: Shtetet duhet të marrin masa për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë.

- * CAT, Neni 14: Viktimat e torturës duhet të kenë mundësinë të përfitojnë nga riparimi, dëmshpërblimi dhe rehabilitimi.
- * ECRE (Fëmijët) parag. 36
- * ECRE (Integrimi), parag. 120-133
- * EU Dir. Pritja, Neni 13(2): Shtetet Anëtare marrin masa lidhur me kushtet materiale të pritjes për të garantuar një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin e kërkuesve dhe të aftë për të garantuar jetesën e tyre. Shtetet Anëtare bëjnë të mundur që të garantohet ky standard jetese në rastin e personave që kanë nevoja të veçanta.
- * EU Dir. Pritja, Neni 17(1): Shtetet Anëtare marrin parasysh situatën e veçantë të personave të cënueshëm si të miturit dhe të miturit e pashoqëruar.
- * EU Dir. Pritja, Neni 18(2): Interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë një faktor parësor gjatë vënies në zbatim të masave që kanë të bëjnë me të miturit.
- * EU Rez., Neni 3(7): Të miturve të pashoqëruar duhet t'u jepet kujdesi i duhur shëndetësor. Ndihmë e veçantë mjekësore apo e një lloji tjetër duhet t'u sigurohet të miturve që kanë vuajtur çdo formë të moskujdesit, shfrytëzimit ose abuzimit, torturës apo çdo lloj forme tjetër të trajtimeve apo dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese apo të konflikteve të armatosura.
- * ICESCR, Neni 12: Shtetet Palë në këtë Pakt njohin të drejtën që ka çdo person për të pasur gjendjen më të mirë shëndetësore, fizike e mendore, që ai është i aftë të arrijë.
- * ICRMW, Neni 28: Punëtorët migrues dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë të drejtën të marrin të gjitha shërbimet mjekësore që janë të nevojshme me urgjencë.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 7.9 - 7.11

11.3 Arsimi, Gjuha dhe Formimi

Fëmijët e ndarë duhet të kenë të njëjtat mundësi të fëmijëve vendas për arsimin e detyrueshëm. Shkollat duhet të kenë një përjasje elastike dhe mirëpritëse kundrejt fëmijëve të ndarë dhe t'u sigurojnë mbështetje në nxënien e një gjuhe të dytë. Në mënyrë që të ruajnë identitetin e tyre kulturor, fëmijët e ndarë duhet të kenë gjithashtu mundësi të mësojnë gjuhën e nënës. Fëmijëve të ndarë më të rritur duhet t'u jepet mundësia e të nxënies dhe formimit profesional. Kjo mund të shtojë mundësitë e tyre në jetë, nëse kthehen në vendlindje.

- * CRC, Neni 28: Fëmijët kanë të drejtën e arsimit fillor falas dhe të detyrueshëm. Shtetet duhet të nxisin forma të ndryshme të arsimit të mesëm dhe t'i bëjnë ato të hapura e të mundshme për të gjithë fëmijët. Orientimi shkollor dhe profesional duhet të jetë i mundshëm e i arritshëm për të gjithë fëmijët.
- * CRC, Neni 29(1c): Arsimimi duhet të ketë për synim të rrisë respektin për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e fëmijës.
- * CRC, Neni 30
- * CRC, Neni 32: Fëmijët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe puna e rrezikshme.
- * CDE, Neni 3: Shtetet duhet të marrin masa të menjëhershme për të eliminuar dhe parandaluar diskriminimin në arsim.
- * CERD, Neni 5, e) V
- * CoE të Rinjtë Migrues, parag. 6.

- * ECRE (Fëmijët), parag. 37-39
- * EU Dir. Pritja, Neni 10(1): Shtetet Anëtare u japin të miturve azilkërkues mundësinë për t'u shkolluar në kushte të ngjashme me vendasit. Shtetet Anëtare nuk duhet t'i mohojnë të miturit të drejtën për të vazhduar arsimin e mesëm vetëm për arsyen se ka arritur moshën ligjore të pjekurisë.
- * EU Dir. Pritja, Neni 10(2): Aksesin në sistemin arsimor nuk duhet të shtyhet për më shumë se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për azil.
- * EU Dir. Pritja, Neni 10(3): Kur aksesin në sistemin arsimor nuk është i mundshëm për shkak të situatës së veçantë të të miturit, Shteti Anëtar mund të ofrojë forma të tjera arsimimi.
- * EU Rez., Neni 3(6): Kur është e mundur të hamendësohet se qëndrimi i një të mituri të pashoqëruar në moshë shkollore do të zgjatet, të miturit duhet t'i jepet mundësia e përdorimit të strukturave të arsimit të përgjithshëm me të njëjtat kushte të vendasve.
- * Karta Sociale Europiane, Pjesa I(7): Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë kundër rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilëve ata ekspozohen.
- * Karta Sociale Europiane, Pjesa I(9): Të gjithë kanë të drejtën e mjeteve të përshtatshme lehtësuese për orientimin profesional.
- * ICESCR, Neni 13(1): Arsimi duhet të bëjë që çdo person të jetë në gjendje të luajë një rol të dobishëm në një shoqëri të lirë, të favorizojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, etnike a fetare.
- * ICRMW, Nenet 43 & 45: Anëtarët e familjeve të punëtorëve migrues gëzojnë barazinë e trajtimit me shtetasit e tjerë për sa i përket hyrjes në institucionet dhe shërbimet edukative dhe në ato të orientimit dhe formimit profesional.
- * UDHR, Neni 26: Gjithkush ka të drejtën e shkollimit.
- * UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 6(2): Shtetet duhet t'i japin rëndësi arsimit tetëvjeçar dhe të mesëm për refugjatët.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 7.12 - 7.14

12. Procesi i Azilit ose i Përcaktimit të Statusit të Refugjatit

12.(a) Fëmijëve të ndarë, pavarësisht nga mosha, nuk duhet t'u mohohet kurrë mundësia për të hyrë në procesin e azilit. Si janë pranuar, ata duhet të kalojnë nëpër procedurat normale dhe të përjashtohen nga procedurat e veçanta si ato lidhur me 'një vend të tretë të sigurt' (pranueshmëria), 'dukshmërisht i pabazuar' (i përshpejtuar) dhe 'vend origjine i sigurt' dhe nga çdo pezullim i kërkesës së tyre për azil për shkak të ardhjes nga një "vend me trazira".

* CRC, Neni 22

* 1951 Konventa e Refugjatëve: Neni 1 i Konventës nuk bën asnjë dallim lidhur me moshën. Personave të çfarëdolloj moshe mund t'u njihet statusi i refugjatit.

* Këshilli i BE Përfundimet mbi vendet në të cilat përgjithësisht nuk ka një rrezik serioz përndjekjeje, 1992

* Këshilli i BE Qëndrimi i përbashkët mbi aplikimin e harmonizuar të përkufizimit të termit 'refugjat, mars 1996

* Këshilli i BE Rezoluta mbi një trajtim të harmonizuar të pyetjeve që kanë të bëjnë me vendet e treta pritëse, 1992

* Këshilli i BE Rezoluta mbi kërkesat për azil dukshmërisht të pabazuara, 1992

* ECRE (Fëmijët), parag. 22 - 23

* EU Rez., Neni 4(1): Çdo i mitur i pashoqëruar duhet të ketë të drejtën të paraqesë një kërkesë për azil.

* EU Rez. Minimum, parag. 26-27: Duhet marrë masa në mënyrë që të miturit e pashoqëruar që kërkojnë azil të përfaqësohen nga një i rritur apo një organ përgjegjës i caktuar posaçërisht. Gjatë intervistës, të miturit e pashoqëruar mund të shoqërohen nga ky i rritur apo përfaqësuesit e organit në fjalë. Gjatë shqyrtimit të formularit të aplikimit të të miturit të pashoqëruar, merren parasysh zhvillimi mendor dhe pjekuria e tij.

* Protokollin lidhur me Statusin e Refugjatëve, 1967

* UDHR, Neni 14(1): "Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë, në vende të tjera, azil nga përndjekjet."

* UNHCR-AP, Pjesa II, Operativi Parag. 6: Shtetet Palë të Konventës së Refugjatëve të v. 1951 u bëjnë thirrje të gjitha Shteteve të marrin masa për të forcuar azilin duke u kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të cënueshme, veçanërisht grave dhe fëmijëve.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag.4.1

12.(b) Në të gjitha fazat e procesit të azilit, duke përfshirë apelimet ose rishikimet, fëmijët e ndarë duhet të kenë një përfaqësues ligjor i cili do ta ndihmojë fëmijën të bëjë kërkesën e tij për azil. Përfaqësuesit ligjorë duhet t'i sigurohen fëmijës pa pagesë dhe, përveç përvojës së duhur në procesin e azilit, ata duhet të jenë të aftë të përfaqësojnë fëmijët dhe të mirinformuar mbi format e përndjekjes specifike për fëmijët.

* CRC, Neni 12

* CRC, Neni 22

* ECRE (Fëmijët), parag. 24

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 4.2 & 8.3

12.1 Garancitë Procedurale Minimale

12.1.1 Vendimet mbi kërkesën e fëmijës për azil duhet të merren nga një autoritet kompetent i cili njih mirë çështjet e azilit dhe të refugjatëve, si edhe të gjitha mjetet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

Fëmijët për të cilët merret një vendim i parë negativ, kanë të drejtën të bëjnë apel. Afatet e apelimit duhet të jenë të arsyeshme.

Kërkesat e fëmijëve duhet të identifikohen dhe të trajtohen me përparësi në mënyrë që ata të mos mbahen në pritje për periudha të gjata kohore.

* ECRE (Fëmijët), parag. 22, 24 & 28

* EU Rez., Neni 4(2): Duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të të miturve dhe gjendjen e tyre të pambrojtur, Shtetet Anëtare duhet ta trajtojnë procesin e kërkesës së tyre për azil si një urgjencë.

* EU Rez. Minimum, 1995, parag. 26-27

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 8.1, 8.2 & 8.5

12.1.2 Parapëlqehet që, veçanërisht në rastet e fëmijëve më të vegjël, fëmijëve me aftësi të kufizuara ose atyre që vuajnë nga trauma psikologjike, një ekspert i pavarur të bëjë një vlerësim të aftësisë së fëmijës për të shprehur një frikë, me bazë, nga përndjekja si dhe të identifikojë çdo vështirësi që një fëmijë mund të ketë në tregimin e ngjarjeve të dhimbshme apo në dhënien e informacioneve delikate.

* EU Rez. Minimum, parag. 27

* ECRE (Fëmijët), parag. 27

* Manuali i UNHCR-së, parag. 214

12.1.3 Në rastet kur janë të nevojshme intervistat, ato duhet të zhvillohen në një mënyrë të përshtatshme për fëmijët (pushime, atmosferë jokërcënuese), nga zyrtarë të trainuar për intervistimin e fëmijëve.

Fëmijët duhet të shoqërohen në çdo intervistë nga përfaqësuesi i tyre ligjor dhe, kur fëmija e dëshiron, nga të rritur të tjerë që kanë lidhje me të (punonjës social, i afërm, kujdestar etj).

Fëmijët e ndarë duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë përmes disa mënyrash të ndryshme. Këto përfshijnë dëshmi verbale, vizatime dhe shkrime, intervista të filmuara me ekspertë të pavarur dhe dëshmi nëpërmjet videos.

* CRC, Neni 3.3

* CoE Rec. Aeroportet, parag. 10, ii.b.

* ECRE (Fëmijët), parag. 26-27

* EU Rez., Neni 4(5)

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 4.2 & 8.4

12.2 Kriteret për Marrjen e një Vendimi mbi kërkesën e një fëmije për azil

12.2.1 Përkufizimi i refugjatit vlen për të gjithë personat, pavarësisht nga mosha. Kur kërkohen zgjidhje afatgjata, duhet treguar vëmendje e veçantë në ruajtjen e një ekuilibri mes parimeve të unitetit familjar dhe parimit që interesi më i mirë i fëmijës është një element parësor. Autoritetet duhet të marrin parasysh Manualin e UNHCR-së, Udhëzimet mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin e Refugjatëve dhe Udhëzimet e 1997, më specifiku:

- moshën dhe pjekurinë e fëmijës dhe stadin e tij të zhvillimit
- faktin që fëmijët mund t'i shfaqin frikërat e tyre ndryshe nga të rriturit
- faktin që fëmijët mund të kenë njohuri të kufizuara mbi kushtet në vendin e tyre të origjinës
- format e dhunimit të drejtave të njeriut specifike për fëmijët, si rekrutimin e fëmijëve në ushtri, trafikimin për prostitucion, shfrytëzimin seksual, gjymtimin e organeve seksuale të femrës dhe punën e detyruar, listë kjo që nuk është shteruese.
- situatën e familjes së fëmijës në vendin e origjinës dhe, nëse njihet, dëshirën që kanë shprehur prindërit për të dërguar një fëmijë jashtë shtetit me qëllimin për ta mbrojtur.
- faktin që veprime të dëmshme që mund të konsiderohen si ngacmim ose diskriminim tek një i rritur, mund të përbëjnë persekutim kur ushtrohen tek një fëmijë.
- prandaj, në shqyrtimin e kërkesave të tyre mund të jetë e nevojshme që t'u jepet një rëndësi më e madhe disa faktorëve objektivë dhe të përcaktohet, në bazë të këtyre faktorëve, nëse mund të hamendësohet që një fëmijë ka frikë me baza nga përndjekja.

* CRC, Nenet 3, 12, 22, 32, 34, 35, 36 & 37

* CRC, Neni 38: Shtetet marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

* Protokollin 1 to CRC

* Protokollin 2 to CRC

* CAT, Neni 1: termi 'torturë' nënkupton çdo veprim me anë të të cilit një personi me dashje i shkaktohet dhimbje ose vuajtje shumë e madhe, fizike ose mendore, për qëllime të tilla siç është marrja prej tij ose prej një personi të tretë e informacioneve ose e një rrëfimi, duke e ndëshkuar atë për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose duke e frikësuar apo duke i bërë presion atij apo një personi të tretë, ose për çdo qëllim tjetër të bazuar në një formë diskriminimi, cilado qoftë ajo, kur një dhimbje ose vuajtje e tillë shkaktohet nga një zyrtar publik ose një person tjetër që vepron në një cilësi zyrtare ose me nxitjen apo miratimin e tij.

* ECHR, Neni 4(1) dhe 4(2) 2

* EU Rez., Neni 4(6): Gjatë shqyrtimit të një kërkesë për azil të një të mituri të pashoqëruar, duhet të merren parasysh mosha e të miturit, pjekuria dhe zhvillimi mendor, dhe fakti që ai mund të ketë njohuri të kufizuara mbi kushtet në vendin e tij të origjinës.

* ICCPR, Neni 8

* ICESCR, Neni 10(3)

* ILO C182, Neni 3

* Protokollin 1 Shtesë e Konventave të Gjenevës të dt. 12/08/1949 Lidhur me Mbrojtjen e

Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare:

Neni 77(2): Palët e përfshira në konflikt duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që fëmijët nën 14 vjeç të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në përlëshje.

* Protokollu II Shtesë e Konventave të Gjenevës të dt. 12/8/1949 Lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jo-Ndërkombëtare

Neni 4(3): Fëmijët nën 15 vjeç nuk rekrutohen në forcat e armatosura dhe nuk lejohen të marrin pjesë në përlëshje.

* Protokollu mbi Trafikimin e Personave

* Fëmijët Refugjatë: Udhëzime mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin, Kapitujt 8 & 9.

* RSICC, Neni 8(2)(b)(xxv) dhe (e)(vii): Rekrutimi apo mobilizimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare në forcat e armatosura kombëtare ose në grupe të armatosura apo përdorja e tyre për të marrë pjesë aktive në përlëshje përbën një krim lufte.

* UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 1(2): Shtetet dhe UNHCR-ja duhet të punojnë sëbashku për të garantuar që autoritetet marrin në konsideratë gjininë dhe moshën, përfshirë forma të përndjekjes të lidhura me moshën apo gjininë.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 8.6 - 8.10, 9.7 & 10.4

* Manuali i UNHCR-së, parag. 203 & 213-219

12.2.2 Fëmijët e ndarë që mbushin moshën e pjekurisë gjatë procesit të azilit vazhdojnë të përfitojnë nga të njëjtat procedura të veçanta prej të cilave përfitojnë ata nën 18 vjeç. Lidhur me këtë, shtetet duhet të eliminojnë vonesa të panevojshme që mund të çojnë në mbushjen e moshës madhore nga fëmija gjatë procesit.

* ECRE (Fëmijët), parag. 30

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.4 & 10.1

13. Zgjidhjet e Qëndrueshme ose Afatgjata

13.1 Qëndrimi në një Vend Pritës/Vend Azili

Një fëmijë i ndarë mund të lejohet të qëndrojë në një vend pritës nëse plotësohen një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

- i njihet atij statusi i refugjatit, si një person që ka nevojë për mbrojtje ose i është aprovuar azili;
- i jepet atij një status de facto ose leje qëndrimi për arsye humanitare ose mëshire sepse është i rrezikshëm kthimi në vendin e origjinës, për shembull, për shkak të një konflikti të armatosur dhe/ose kur prindërit e fëmijës nuk gjenden dhe nuk ka kujdestar të përshtatshëm në vendin e origjinës apo për arsye mjekësore;
- ai është viktimë e trafikimit dhe kthimi në vendin e tij të origjinës është i rrezikshëm;
- është e qartë që interesi më i mirë i fëmijës është të qëndrojë në atë vend.

* CRC, Neni 3

* ECRE (Fëmijët), parag. 42

* EU Rez., Neni 5(2): Për sa kohë kthimi nuk është i mundur, Shtetet Anëtare duhet të mundësojnë qëndrimin e të miturit.

* Protokollin mbi Trafikimin e Personave, Neni 7

* Fëmijët Refugjatë: Udhëzime mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 9.1 & 9.4

13.2 Bashkimi Familjar

Fëmijët e ndarë që kërkojnë azil ose ndodhen në një shtet Europian për arsye të tjera ndonjëherë kanë anëtarë të familjes në shtete të tjerë të Europës. Shtetet Europiane duhet të lehtësojnë pozitivisht dhe aktivisht ribashkimin familjar të fëmijës, në shtetin ku plotësohen interesat më të mira të fëmijës, në përputhje me garancitë e paraqitura në paragrafin 13.6.

Në çdo situatë lidhur me një fëmijë të ndarë, shtetet Europiane duhet të lehtësojnë ribashkimin e familjes në vendin ku fëmija po jeton, nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.

Kur një fëmijë i ndarë ka një anëtar të familjes në një vend të tretë dhe, si fëmija ashtu edhe anëtarët e familjes, dëshirojnë të ribashkohen në atë vend, autoritetet për mirëqenien e fëmijës duhet të kryejnë një hetim të kujdesshëm të aftësisë së anëtarit të familjes për t'u kujdesur për fëmijën.

* CRC, Neni 10(1)

* CoE Të Rinjtë Migrues, parag. 7 vii-ix.

* Dublin II, Neni 15(3): Nëse kërkuesi i azilit është një fëmijë i pashoqëruar që ka një ose disa të afërm që mund të kujdesen për të në një tjetër Shtet Anëtar, Shtetet Anëtare duhet, nëse është e mundur, ta bashkojnë fëmijën me të afërmin ose të afërmit, përveç rastit kur kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.

- * ECHR, Neni 8.1.
- * ECRE (Fëmijët), parag. 32, 34 & 35
- * ECRE (Integrimi), parag. 139
- * EU Dir. Familja, Neni 10.3(a): Nëse refugjati është një i mitur i pashoqëruar, Shtetet Anëtare autorizojnë hyrjen dhe qëndrimin, me qëllim bashkimin familjar, të kushërinjve të parë dhe familjes së ngushtë.
- * EU Rez., Neni 5(3a): Autoritetet kompetente duhet të bashkëpunojnë në ribashkimin e të miturve të pashoqëruar me anëtarë të tjerë të familjes së tyre, qoftë në vendin e origjinës së të miturit, qoftë në vendin ku këta anëtarë të familjes jetojnë.
- *Këshilli i EU Rezoluta mbi harmonizimin e politikave kombëtare për bashkimin familjar, 3 qershor 1993
- * ICCPR, Neni 23(1)
- * ICRMW, Neni 44(1)
- * UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 1(2): Shtetet duhet të paraqesin ose të shtojnë garancitë që kanë të bëjnë me gjininë dhe moshën në procedurat e azilit duke i dhënë rëndësinë e duhur parimit të unitetit familjar.
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.5, 10.5 & 10.11

13.3 Integrimi

13.3.1 Pasi një fëmije të ndarë i është lejuar të qëndrojë, autoritetet e përkujdesjes/mirëqenies duhet të bëjnë një vlerësim të kujdesshëm të situatës së fëmijës (duke marrë parasysh moshën, gjininë, të kaluarën e tij sociale, shëndetin mendor ose fizik, arsimin dhe situatën e familjes së tij në vendin e origjinës). Paskëta, duke u konsultuar me fëmijën, i duhet gjetur atij një sistemim afatgjatë në komunitet. Kjo sigurisht mund të jetë edhe një përzgjatje e sistemimit të përkohshëm. Në përgjithësi dëshirohet që për fëmijët nën 15/16 vjeç të kujdeset një familje kujdestare që i përket të njëjtës kulturë. Fëmijët më të rritur mund të preferojnë të jetojnë/përshtaten në vatrën familjare, në grupe të vogla. Këto struktura duhet të drejtohen nga punonjës socialë me formimin e duhur të cilët i njohin mirë nevojat kulturore të fëmijëve të ndarë.

Në parim, vëllezërit dhe motrat duhet të mbahen bashkë në të njëjtin vend, përveçse kur ata dëshirojnë të kundërtën ose kur kjo nuk është në interesin e tyre më të mirë. Nëse një grup vëllezërisht dhe motrash jeton në mënyrë të pavarur, nën përgjegjësinë e më të madhit, atëherë këtij të fundit duhet t'i sigurohet mbështetje dhe këshillim i veçantë.

Fëmijëve të ndarë që kanë arritur moshën madhore duhet t'u ofrohet mbështetje nëpërmjet një programi "post-asistence", për t'i ndihmuar ata në kalimin në jetën e pavarur.

- * CRC, Nenet 13, 14, 15, 16, 19, 20, 25, 26 & 27
- * 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 21: Dispozita mbi strehimin e refugjatëve të njohur si të tillë.
- * 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 23: Dispozita mbi "ndihmën publike" për refugjatët e njohur si të tillë.
- * 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 24: Dispozita mbi kushtet e punës dhe sigurimet

shoqërore të refugjatëve të njohur si të tillë

* ECRE (Fëmijët), parag. 19

* EU Rez., Neni 4(7): Sapo një të mituri të pashoqëruar i jepet statusi i refugjatit ose çdo e drejtë tjetër qëndrimi të përhershëm, duhet t'i sigurohet atij një strehim afatgjatë.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 10.2-10.3 & 10.6 - 10.9

13.3.2 Të drejtat e fëmijëve të ndarë për arsimim dhe formim, kujdes shëndetësor, ndihmë gjuhësore (sipas paragrafit 11.3) dhe punësim duhet të jenë të njëjta me ato që u ofrohen fëmijëve vendas dhe në përputhje me ligjet kombëtare.

Fëmijët e ndarë të cilët kanë mbërritur si të mitur dhe u është dhënë leja e qëndrimit për arsye humanitare ose mëshire apo kanë marrë ndonjë lloj tjetër statusi të përkohshëm që skadon në moshën 18-vjeçare, duhet të trajtohen me zemërgjerësi kur arrijnë moshën madhore dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë statusit të tyre si të pambrojtur. Atyre duhet t'u lejohet qëndrimi në vendin pritës.

* CRC, Nenet 2, 3, 23, 24, 28, 29(1c) & 30

* CRC, Neni 31: Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike; Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin këto të drejta dhe inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

* CRC, Neni 39

* 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 22: Të drejtat për arsimim të refugjatëve të njohur si të tillë.

* ECRE (Fëmijët), parag. 36 - 41

* ECRE (Integrimi), parag. 103-107

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 10.10

13.4 Birësimi

Birësimi është rrallë, në mos kurrë, një mundësi e përshtatshme për një fëmijë të ndarë. Përpara se birësimi të konsiderohet i realizueshëm ose i dëshirueshëm, është i rëndësishëm një vlerësim rigoroz, drejtuar nga një organizatë e autorizuar, i situatës së familjes së fëmijës në vendin e origjinës. Procedura të qarta lidhur me këtë janë përshkruar në rekomandimin e Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

* CRC, Neni 21: Detyrimet e Shteteve lidhur me birësimin në një vend tjetër.

* Konventa e Hagës 1993

* Rekomandim në Lidhje me Aplikimin e Konventës së Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për sa i përket Birësimin në një vend tjetër tek Fëmijët Refugjatë dhe Fëmijët të Tjerë të Larguar nga Vendi i Tyre, Tetor 1994

* Udhëzimet e UNHCR-së, Parag. 10.4 & 10.8.

13.5 Identiteti dhe Nënshtetësia

Fëmijët e ndarë që zbulohen se janë të pashtet, duhet të ndihmohen në marrjen e një nënshtetësie.

- * CRC, Neni 7(1): Fëmijët kanë të drejtën për të fituar një shtetësi.
- * 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 27 & 28: Shtetet u lëshojnë refugjatëve të njohur si të tillë karta identiteti dhe dokumenta udhëtimi.
- * 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 34: Shtetet lehtësojnë natyralizimin e refugjatëve.
- * Konventa Lidhur me Statusin e Personave të Pashtet, 1954, Neni 32: Shtetet lehtësojnë natyralizimin e personave të pashtet.
- * CRS
- * ICCPR, Neni 24(3): Çdo fëmijë ka të drejtën për të fituar një shtetësi.

13.6 Kthimi në Vendin e Origjinës

13.6.1 Kjo është një fushë e ndërlikuar dhe, për implementimin e praktikave të mira, nevojitet një udhëheqje e detajuar. Një fëmijë i ndarë duhet të kthehet mbrapsht vetëm nëse ky kthim vlerësohet si interesi më i mirë i fëmijës. Të gjithë faktorët e tjerë, si p.sh. lufta kundër emigracionit të paligjshëm, duhet të jenë dytësorë.

Mënyra më e mirë për të kryer ribashkimin familjar dhe kthimet është ajo e vullnetshme. Fëmijët duhet të informohen plotësisht, të konsultohen dhe pikëpamjet e tyre duhet të merren parasysh në të gjitha fazat e procesit. Kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijës larg vendit të origjinës dhe mosha e tij janë faktorë të rëndësishëm që duhen marrë parasysh në këtë proces.

- * CRC, Neni 3
- * Protokollin mbi Trafikimin e Personave Përkufizimi, Neni 8: Shtetet lehtësojnë riatdhesimin e viktimave të trafikimit
- * Fëmijët Refugjatë: Udhëzime mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin, UNHCR, 1994, p. 138-144
- * Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 9.4 & 10-12

13.6.2 Para se një fëmijë i ndarë të kthehet në vendin e origjinës, duhet të sigurohemi që:

- është bërë një vlerësim i kujdesshëm mbi sigurinë e kthimit të fëmijës në atdhe, duke marrë në konsideratë rrezikun e përndjekjes, të përfshirjes në konflikte të armatosura, të dhunës dhe abuzimit si dhe të shfrytëzimit;
- personi përgjegjës për fëmijën dhe kujdestari/këshilluesi i tij në vendin pritës janë dakord se kthimi është në interesin më të mirë të fëmijës;
- është bërë një vlerësim i kujdesshëm i situatës së familjes në vendin e origjinës. Është e nevojshme të hetohet aftësia e familjes së fëmijës (prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes) për të siguruar përkujdesjen e duhur;
- është bërë një vlerësim i kujdesshëm i mundësive për të siguruar ushqim, strehim, kujdes shëndetësor, arsimim, formim profesional dhe punësim në atdhe;

- këto hetime kryhen nga një organizatë profesioniste dhe e pavarur (që është e ndryshme nga organi ose personi/personat që bëjnë vlerësimin fillestar mbi kërkesën e fëmijës për të qenë refugjat apo kërkesa të tjera) dhe duhet të jenë objektive, apolitike dhe të marrin në konsideratë në çdo rast interesat më të mira të fëmijës;

- prindërit, të afërmit ose të rritur të tjerë përgjegjës për fëmijën janë dakord t'i sigurojnë atij kujdes afatgjatë sapo të mbërrijë në vendin e origjinës. Pikëpamjet e familjes mbi rikthimin e fëmijës duhet të hetohen dhe të merren në konsideratë;

- fëmija informohet plotësisht dhe konsultohet në të gjitha fazat dhe i sigurohet atij këshillimi dhe ndihma e duhur; gjithashtu pikëpamja e fëmijës mbi rikthimin duhet të merret në konsideratë, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij;

- përpara kthimit mundësohet kontakti midis fëmijës dhe familjes së tij;

- gjatë kthimit fëmija shoqërohet siç duhet;

- pas kthimit mirëqenia e fëmijës do të monitorohet nga autoritete ose agjensi të përshtatshme. Fëmijët viktimë të trafikimit nuk duhet të kthehen asnjëherë në vendin e tyre të origjinës pa një vlerësim të kujdesshëm të kontekstit të familjes dhe të rrezikut të mundshëm të masave ndëshkimore ose ritrafikimit, në mënyrë që të garantohet që fëmija po kthehet në një ambient të sigurtë.

Fëmijët e ndarë që erdhën si të mitur por që kanë arritur moshën 18-vjeçare dhe nuk janë lejuar të qëndrojnë në vendin pritës duhet të trajtohen si persona të rrezikuar dhe të konsultohen mbi kushtet e nevojshme për një riintegrim të suksesshëm në vendin e tyre të origjinës.

* CRC, Neni 3

* CRC, Neni 5: Shtetet respektojnë të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose anëtarët e familjes së zgjeruar për t'i dhënë fëmijës drejtësinë dhe udhëheqjen e duhur

* CRC, Nenet 6, 12, 19, 20, 24, 27, 28, 34, 35, 36, 37(a), 38 & 39

* 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 32(1): Shtetet nuk mund të dëbojnë një refugjat që gjendet në territorin e tyre në mënyrë të ligjshme.

* 1951 Konventa e Refugjatëve, Neni 33

* CAT, Neni 3

* CoE Rek. mbi Dëbimin, parag. 13.v.h: të miturit e pashoqëruar duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme me moshën e tyre dhe duhet të merren menjëherë në ngarkim nga një gjykatës për të mitur e t'u mundësohet konsultimi dhe përfaqësimi i pavarur ligjor.

* CoE të Rinjtë Migrues, parag. 7, x

* ECRE (Fëmijët), parag. 33 & 42

* EU Rez., Neni 5

* UNHCR-AP, Pjesa III, Qëllimi 2(7): Shtetet, duke punuar në konsultim me organizata ndërqeveritare të përshtatshme, duhet të hartojnë strategji për të nxitur kthimin dhe ripranimin e personave që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, në një mënyrë humane e duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e tyre njerëzor, pa përdorur forcë të tepruar dhe, në rastin e fëmijëve, duke marrë mirë parasysh interesin e tyre më të mirë.

* Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 9.4, 9.5, 10.5, 10.12 - 10.14

SHTOJCA I

E KALUARA SHOQËRORE

Re. paragraf C7 sipër, informacioni i mëposhtëm rreth një fëmije duhet të mblidhet nga një organizatë përgjegjësie e së cilës është kujdesi për fëmijën:

1. Informacion mbi familjen (në vendin e origjinës dhe gjetiu)
 2. Informacion mbi personat që nuk janë anëtarë të familjes, por të rëndësishëm për fëmijën
 3. Rrethanat në të cilat fëmija u gjet/identifikua
 4. Informacion në lidhje me ndarjen e fëmijës nga familja
 5. Informacion rreth jetës së fëmijës përpara ndarjes dhe që nga ai moment
 6. Gjëndja fizike e fëmijës, shëndeti dhe historia e kaluar mjekësore
 7. Niveli i arsimit (formal and jo-formal)
 8. Mënyrat aktuale të përkujdesjes
 9. Dëshirat dhe planet e fëmijës për të ardhmen
 10. Vlerësim paraprak i zhvillimit dhe pjekurisë mendore dhe emocionale të fëmijës
 11. Vlerësimi i moshës
- (Udhëzimet e UNHCR-së, parag. 5.9)

SHTOJCA II

E DREJTA, POLITIKAT DHE UDHËZIMET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

1. Dokumentat Ligjore Ndërkombëtare mbi të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

- Konventa për Mbrojtjen e të Miturve, 1961
- Konventa mbi Aspektet Ligjore të Rrëmbimit të të Miturve në një vend tjetër, 1980
- Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private
- Konventa e Hagës mbi Jurisdikcionin, Ligjet e Zbatueshme, Përforcimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve, 1996
- Konventa e Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin në një vend tjetër, 1993
- ILO Konventa lidhur me Ndalimin dhe Masat e Menjëhershme për Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, C182, 1999
- Protokoll i Opsional mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosura, 2000
- Protokoll i Opsional mbi Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve, 2000
- Rekomandim në Lidhje me Aplikimin e Konventës së Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për sa i përket Birësimin në një vend tjetër tek Fëmijët Refugjatë dhe Fëmijë të Tjerë të Larguar nga Vendi i Tyre, Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Tetor 1994
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1989
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Fëmijëve të cilëve u Është Hequr Liria, 1990
- Rregullat Standarde Minimale për Administrimin e së Drejtës për të Rinjtë (Rregullat e Pekinit), 1985

2. Ligjet Ndërkombëtare

- Konventa kundër Diskriminimit në Arësim, 1960
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, 1984
- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, 1979
- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1965
- Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë, 1961
- Konventa Lidhur me Statusin e Personave të Pashtet, 1954
- Konventa Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migruerë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre, 1990
- Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966 (dhe Protokoll i Opsional)
- Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale and Kulturore, 1966
- Protokoll i Shtesë i Konventave së Gjenevës i dt. 12 Gusht 1949 që ka Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokoll i I), 8 Qershor 1977, Nenet 77 dhe 78
- Protokoll i Shtesë i Konventave së Gjenevës i dt. 12 Gusht 1949 që ka Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve Jo-Ndërkombëtare të Armatosura (Protokoll i II), 8 Qershor 1977, Neni 4
- Protokoll i Kundër Kontabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000
- Protokoll i lidhur me Statusin e Refugjatëve, 1967
- Protokoll për Parandalimin, Frenimin dhe Dënimin e Trafikimit të Njerëzve, Veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000
- Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve, 1998
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo, 2000
- Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve, 1951
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948

3. Dokumentat Ligjore Europiane

- Konventa Europiane për Adoptimin e Fëmijëve e dt. 24/04/67

- Konventa Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve e dt. 25/01/96
- Konventa Europiane për Statusin Ligjor të fëmijëve të Lindur jashtë Martese e dt. 15/10/75
- Konventa Europiane për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve Lidhur me Kujdestarinë e Fëmijëve dhe për Rivendosjen e Kujdestarisë së Fëmijëve e 20/05/80
- Karta Sociale Europiane, 1961

4. Legjislacioni i Bashkimit Europian për Azilet dhe Emigrimin

- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, Dhjetor 2000
- Direktiva e Këshillit 2001/40/KE mbi njohjen e ndërsjellë të vendimeve mbi dëbimin e shtetasve të vendeve të treta
- Direktiva e Këshillit 2001/55/KE e 20 korrikut 2000 mbi standardet minimale për dhënien e një mbrojtjeje të përkohshme në rastin e një fluksi masiv refugjatësh dhe mbi masat për të ruajtur ekuilibrin mes përpjekjeve të Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe pranimin e pasojave që kjo sjell.
- Direktiva e Këshillit 2003/9/KE që parashtron standardet minimale për pritjen e kërkuesve të azilit
- Direktiva e Këshillit 2003/86/KE e 22 shtatorit 2003 mbi të drejtën për bashkimin familjar
- Rregullativa (EC) Nr. 343/2003 e Këshillit që vendos kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil paraqitur në njërin prej Shteteve Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë (Dublin II)
- Rregullativa e Këshillit (KE) Nr. 2725/2000 që ka të bëjë me krijimin e sistemit 'Eurodac' për krahasimin e shenjave të gishtërinjve me qëllim aplikimin efektiv të Konventës së Dublinit
- Komunikata e Komisionit Europian mbi Menaxhimin e Kufijve të Jashtëm të Shteteve Anëtare të BE-së, maj 2002
- Konventa Europiane mbi Heqjen Graduale të Kontrolleve në Kufijtë e Përbashkët, 1985 (Marrëveshja Shengen)
- Vendimi mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Shtator 2002
- Plani për luftën kundër emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore, Këshilli i BE-së, qershor 2002
- Konventa për Implementimin e Marrëveshjes Shengen, 1990

5. Udhëzimet e UNHCR-së dhe Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së

- Udhëzime mbi Politikat dhe Procedurat në lidhje me Fëmijët e Pashoqëruar që Kërkojnë Azil, 1997
- Manual mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit, 1992.
- Fëmijët Refugjatë: Udhëzime mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin, 1994
- Rivendosja e Refugjatëve: Një Manual Ndërkombëtar për të Udhëhequr Pritjen dhe Integrimin, Kapitulli 3.3, Të Investosh tek e Ardhmja: Fëmijët dhe të Rinjtë Refugjatë, 2002
- Axhenda e UNHCR-së për Mbrojtjen, 2002
- Përfundimi Nr. 47 (1987) i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së mbi "Fëmijët Refugjatë"
- Përfundimi Nr. 59, (1989) i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së mbi "Fëmijët Refugjatë"
- Përfundimi Nr. 84, (1997) i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së mbi "Fëmijët dhe adoleshentët Refugjatë"
- Përfundimi Nr. 88, (1999) i Komitetit Ekzekutiv të UNHCR-së mbi "Mbrojtjen e Familjeve të Refugjatëve"
- Udhëzimet e UNHCR-së mbi Përrjashtimet, 1996
- Puna me Fëmijët e Pashoqëruar: Një Përfaqje me Komunitare, 1996

6. Deklaratat, Rezolutat dhe Udhëzimet e KB

- Deklarata mbi Parimet Sociale dhe Ligjore që lidhen me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, e përqëndruar veçanërisht tek Vendosja në Familje Kujdestare dhe Adoptimi në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar, 1986
- Deklarata për të Drejtat e Njeriut të Personave që nuk e kanë Nënshpëtimin e Vendit në të cilin Jetojnë, 1985
- Deklarata për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, 1992
- Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara nga UNHCHR-ja mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, E/2002/68/Add.1, 20 maj 2002
- Nënkomisioni i UNHCHR-së mbi rezolutën e të Drejtave të Njeriut 2002/51 për Trafikun e grave dhe vajzave

7. Rezolutat dhe Rekomandimet e Bashkimit European

- Deklarata e Brukselit mbi Parandalimin dhe Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Këshilli i BE-së, 29 Nëntor 2002, JAI 280, SOC 572
- Përfundimet mbi vendet në të cilat përgjithësisht nuk ka një rrezik serioz përndjekjeje, Këshilli i BE-së, 1992
- Përfundimet mbi kushtet e pritjes për kërkuesit e azilit, Këshilli i BE-së, shtator 2000
- Vendimi i Këshillit mbi monitorimin dhe implementimin e dokumentave ligjore të adoptuara lidhur me azilin, Këshilli i BE-së, qershor 1997
- Veprime të Përbashkëta për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve, Këshilli i BE-së, shkurt 1997 (97/1 54/JHA)
- Qëndrimi i përbashkët i 4 marsit 1996, përcaktuar nga Këshilli bazuar mbi Nenin K.3 të Traktatit të Bashkimit European, mbi aplikimin e harmonizuar të përkufizimit të termit 'refugjat' në Nenin 1 të Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 që ka të bëjë me statusin e refugjatëve (96/196/JHA)
- Rezoluta mbi ndarjen e detyrave lidhur me pranimin dhe qëndrimin e përkohshëm të refugjatëve, Këshilli i BE-së, shtator 1995
- Rezoluta mbi një përfaqje të harmonizuar të pyetjeve që kanë të bëjnë me vendet e treta pritëse, Këshilli i BE-së, 1992
- Rezoluta mbi kërkesat për azil dukshëmrisht të pabazuara, Këshilli i BE-së, 1992
- Rezoluta mbi Garancitë Minimale për Procedurat e Azilit, Këshilli i BE-së, 1995
- Rezoluta mbi harmonizimin e politikave kombëtare mbi bashkimin familjar, Këshilli i BE-së, qershor 1993
- Rezoluta mbi të miturit e pashoqëruar që janë qytetarë të vendeve të treta, Këshilli i BE-së, qershor 1997 (97/C 221/03)

8. Rezolutat dhe Rekomandimet e Këshillit të Europës

- Rekomandimi Nr. R (91) 11 i Komitetit të Ministrave në Lidhje me Shfrytëzimin Seksual, Pornografinë, Prostitucionin dhe Trafikimin e fëmijëve dhe të rinjve
- Rekomandimi Nr. R (2000) 11 i Komitetit të Ministrave mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual
- Deklarata Përfundimtare e Konferencës së 7-të të Ministrave përgjegjës për Çështjet e Emigracionit, shtator 2002
- Rekomandimi 1237 (1994) i Asamblesë Parlamentare mbi situatën e azilkërkuesve aplikimet për azil të të cilëve janë refuzuar
- Rekomandimi 1309 (1996) i Asamblesë Parlamentare mbi trainimin e nëpunësve që presin kërkuesit e azilit në pikat kufitare
- Rekomandimi 1327 (1997) i Asamblesë Parlamentare mbi mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut të refugjatëve dhe kërkuesve të azilit në Europë
- Rekomandimi 1475 (2000) i Asamblesë Parlamentare. Mbërritja e kërkuesve të azilit në aeroportet europiane
- Rekomandimi 1547 (2002) i Asamblesë Parlamentare mbi Procedura Dëbimi të bazuara tek të drejtat e njeriut dhe të zbatuara duke respektuar sigurinë dhe dinjtetin
- Rekomandimi 1577 (2002) i Asamblesë Parlamentare, Krijimi i një karte mbi emigrimin klandestin
- Rekomandimi 1596 (2003) i Asamblesë Parlamentare. Situata e të Rinjve Migrues në Europë

9. Dokumentat e OSCE-së

- Planveprimi i OSCE-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Takimi Ministror i Mاستriktit, 2003

10. Qëndrimi i Këshillit European ndaj Refugjatëve dhe të Dëbuarve

- Këshilli European mbi Refugjatët dhe të Dëbuarit: Qëndrimi ndaj Fëmijëve Refugjatë, 1996
- Këshilli European mbi Refugjatët dhe të Dëbuarit: Qëndrimi ndaj Integritit të Refugjatëve në Europë, dhjetor 2002

SHTOJCË III

REFERENCAT E PËRDORURA

Këto referenca nisin me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe protokollat shtesë dhe më pas citohen me shkurtimet e përdorura të shoqëruara edhe nga pjesë të nenit/paragrafit përkatës apo nga *link*-et .

KDF, Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve, 1989

Neni. 2(1): Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2(2): Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni. 3(1): Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese

Neni. 3(3): Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni. 5: Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjorisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni. 6(1): Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

Neni. 7(1): Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

Neni. 8(1): Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.

Neni. 8(2): Në qoftë se një fëmije i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni. 9(3): Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës. 4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni. 10(1): Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Shtetet Palë në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

Neni. 10(2): Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni. 12(1): Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.

Neni. 12(2): Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Neni. 13(1): Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kujfijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.

Neni. 13(2): Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

(a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve; ose (b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni. 14(1): Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

Neni. 14(2): Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

Neni. 14(3): Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Neni. 15(1): Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

Neni. 15(2): Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Neni. 16(1): Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

Neni. 16(2): Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni. 17: Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Për këtë qëllim Shtetet Palë:

(a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29; (b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare; (c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë; (d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysht, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton; (e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysht dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni. 18(2): Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët.

Neni. 19(1): Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

Neni. 19(2): Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni. 20(1): Një fëmije, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

Neni. 20(3): Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysht dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Neni. 21: Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e birësimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesin më të lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që birësimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që birësimi të lejohet duke mbajtur parasysht gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për birësimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm; (b) Pranojnë se birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje kujdestare ose birësuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme përkujdesjeje në vendin e tij të origjinës; (c) Sigurojnë që, në rast birësimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e birësimit në vendin e tij; (d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast birësimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të; (e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përipiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni. 22(1): Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.

Neni. 22(2): Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni. 23(1): Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

Neni. 23(2): Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme, dhënien e fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

Neni. 23(3): Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me aftësi të kufizuara, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektive të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

Neni. 23(4): Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimi, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni. 24(1): Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

Neni. 24(2): Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:
(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmimore; (b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor; (c) Për të luftuar sëmundjen dhe keqshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror; (d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes; (e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për

shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve; (f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

Neni. 24(3): Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Neni. 24(4): Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni. 25: Shtetet Palë i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesje, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni. 26(1): Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni. 26(2): Ndhimat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni. 27(1): Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Neni. 27(2): Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.

Neni. 27(3): Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevoje, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.

Neni. 27(4): Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet Palë favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni. 28(1): Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

(a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë; (b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevoje; (c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme; (d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional; (e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Neni. 28(2): Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

Neni. 28(3): Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni. 29(1c): Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim: Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;

Neni. 30: Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmijë që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrisë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni. 31(1): Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.

Neni. 31(2): Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni. 32: Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.

Neni. 34: Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që: (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale; (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme; (c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni. 35: Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni. 36: Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij.

Neni. 37(a): Shtetet Palë sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;

Neni. 37(b): Shtetet Palë sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmijë duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

Neni. 38: Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.

Neni. 39: Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Protokolli 1 i CRC, Protokolli Opsional mbi Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë e Fëmijëve, 2000

Neni 3: Kërkon që shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe trafikimi i fëmijëve për çdo qëllim (transplant organesh, birësim, prostitucion, punë të detyruar) të mbulohen nga e drejta penale.

Neni 8(1): Shtetet duhet të adoptojnë masa të përshtatshme për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijëve viktimë të shfrytëzimit seksual dhe trafikimit.

Protokolli 2 i CRC, Protokolli Opsional mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosura, 2000

Link: <http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/protocolchild.htm>

1951 Konventa e Refugjatëve

Neni. 31: Shtetet nuk duhet të penalizojnë personat që hyjnë ose ndodhen në mënyrë të paligjshme në një vend nëse ata kanë ardhur nga një territor ku ishin objekt përndjekjeje sipas kuptimit të parashikuar në Nenin 1 *dhe* Nuk duhet të jepen dënime për azilkërkesit të cilët hyjnë në mënyrë të paligjshme në një vend nëse ata janë në gjendje të paraqesin arsye të vlefshme për hyrjen e tyre të paligjshme.

Neni. 33: Shtetet nuk duhet të kthejnë një refugjat në një vend ku jeta ose liria e tij janë të rrezikuara sipas kuptimit të parashikuar në Nenin 1.

CAT, Konventa Kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, 1984

Neni. 3: Asnjë shtet nuk i kthen personat në një vend ku rrezikojnë t'i nënshtrohen torturave.

CERD, Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, 1965

Link: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/d_icerd.htm

CoE Ministrat 91, Rekomandimi Nr. R (91) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në Lidhje me Shfrytëzimin Seksual, Pornografinë, Prostitucionin dhe Trafikimin e Fëmijëve dhe të Rinjve.

Link: <http://cm.coe.int/ta/rec/1991/91r11.htm>

CoE Ministrat 2000, Rekomandimi Nr. R (2000) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual

Link: <http://cm.coe.int/ta/rec/2000/2000r11.htm>

CoE Rec. Aeroportet, Rekomandimi 1475 (2000) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Mbërritja e kërkuarve të azilit në Aeroportet Europiane

Link: <http://assembly.coe.int/Documents/AdoptedText/TA00/EREC1475.htm>

CoE Rec. Trainimi i Nëpunësve, Rekomandimi 1309 (1996) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës mbi trainimin e nëpunësve që presin kërkuarve të azilit në pikat kufitare

Link: <http://assembly.coe.int/Documents/AdoptedText/ta96/EREC1309.htm>

CoE të Rinjtë Migrues, Rekomandimi 1596 (2003) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Situata e të Rinjve Migrues në Europë

Link: <http://assembly.coe.int/Documents/AdoptedText/ta03/EREC1596.htm>

Këshilli i BE: Deklarata e Brukselit mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, maj 2003

Link: http://europa.eu.int/eur-lex/en/dat/2003/c_137/c_13720030612en00010009.pdf

Këshilli i BE Përfundimet mbi vendet në të cilat përgjithësisht nuk ka një rrezik serioz për ndjekjeje, Këshilli i BE-së, 1992

S'ka link

Këshilli i BE Veprime të përbashkëta për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve, 24 shkurt 1997

Link: http://ue.eu.int/ejn/data/vol_b/5_actions_communes/coopera_judiciaire/l-063-04031997-2-6-en.html

Këshilli i BE Qëndrimi i përbashkët mbi aplikimin e harmonizuar të përkufizimit të termit 'refugjat', mars 1996

Link: http://europa.eu.int/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexapi!prod!CELEXnumdoc&lg=EN&numdoc=31996F0196&model=guichett

Këshilli i BE Rezoluta mbi një trajtim të harmonizuar të pyetjeve që kanë të bëjnë me vendet e treta pritëse, 1992

– S'ka link

Këshilli i BE Rezoluta mbi kërkesat për azil dukshëmrisht të pabazuara, 1992

S'ka link

Këshilli i EU Rezoluta mbi harmonizimin e politikave kombëtare për bashkimin familjar, 3 qershor 1993

S'ka link

CRS, Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë, 1961

Link: <http://www.unhcr.md/article/convstateless61.htm>

ECHR, Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (dhe Protokollet), 1950

Neni.3. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni. 4: Askush nuk mund të mbahet në skllavëri as në robëri apo shtrëngohet të kryejë punë të detyruar.

Neni. 8.1: Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij.

ECRE (Fëmijët), Këshilli European Mbi Refugjatët dhe të Dëbuarit: Qëndrimi ndaj Fëmijëve Refugjatë, 1996

Link: <http://www.ecre.org/positions/children.pdf>

ECRE (Integrimi), Këshilli European Mbi Refugjatët dhe të Dëbuarit: Qëndrimi mbi Integrimin e Refugjatëve në Europë, dhjetor 2002

Link: <http://www.ecre.org/positions/integ02.pdf>

EU Rez., Rezoluta mbi të miturit e pashoqëruar që janë shtetas të vendeve të treat, Këshilli i BE-së, qershor 1997 (97/C 221/03)

Neni. 2(3): Fëmijët e pashoqëruar që, sipas të drejtës kombëtare, duhet të qëndrojnë në kufi deri kur të merret një vendim për pranimin e tyre në territor apo për kthimin e tyre mbrapsht, duhet të marrin çdo mbështetje materiale dhe çdo përkujdesje të nevojshme për të përmbushur nevojat e tyre themelore si ushqimi, strehimi i përshtatshëm për moshën e tyre, pajisjet sanitare dhe përkujdesja mjekësore.

Neni. 3(1): Shtetet Anëtare duhet të përpiqen të përcaktojnë identitetin e fëmijës sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes së tij sikurse edhe faktin që ai është i pashoqëruar. Informacionet mbi identitetin dhe situatën e të miturit mund të merren me mënyra të ndryshme veçanërisht nëpërmjet një interviste të përshtatshme që duhet marrë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në një mënyrë të përshtatshme me moshën e tij. Informacioni i marrë duhet të dokumentohet në mënyrë efektive. Në kërkimin, mbledhjen, përcjelljen dhe ruajtjen e informacionit të marrë duhet të përdoret kujdes dhe fshehtësi e veçantë, veçanërisht në rastin e azilkërkuesve, në mënyrë që të mbrohen si i mituri ashtu edhe anëtarët e familjes së tij. Marrja e këtij informacioni sa më shpejt mund të rrisë në mënyrë të veçantë mundësitë e ribashkimit të të miturit me familjen e tij në vendin e origjinës ose në një vend të tretë.

Neni. 3(2): Pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor, të miturve të pashoqëruar duhet t'u jepet e drejta për të pasur mbrojtjen dhe kujdesin themelor të nevojshëm në përputhje me çka parashikon legjislacioni kombëtar.

Neni. 3(3): Shtetet Anëtare duhet, me qëllimin e ribashkimit, të bëjnë çdo përpjekje për të gjetur, sa më shpejt që të jetë e mundur, anëtarët e familjes së një të mituri të pashoqëruar ose për të identifikuar vendin e tyre të banimit, pa marrë parasysh statusin e tyre ligjor dhe pa paragjykuar karakterin e ligjshëm të çdo kërkesë për qëndrim. Të miturit e pashoqëruar gjithashtu mund të nxiten dhe të ndihmohen që të kontaktojnë Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, organizatat kombëtare të Kryqit të Kuq ose organizata të tjera për kërkimin e anëtarëve të familjeve të tyre. Veçanërisht në rastin e azilkërkuesve, kurdo që të vendosen kontakte në kuadrin e gjetjes së anëtarëve të familjes, fshehtësia duhet ruajtur në masën e duhur në mënyrë që të mbrohen si i mituri ashtu edhe anëtarët e familjes së tij.

Neni. 3(4&5): Me qëllim zbatimin e kësaj Rezolute, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë sa më shpejt përfaqësimin e nevojshëm për fëmijën nga: a) kujdestari ligjor, ose b) përfaqësimi nga një organizatë (kombëtare) që është përgjegjëse për kujdesin dhe mirëqenien e të miturve ose c) përfaqësim tjetër i përshtatshëm. Kur caktohet një kujdestar për një fëmijë të pashoqëruar, ky kujdestar duhet të garantojë, në përputhje me të drejtën kombëtare, plotësimin e nevojave (p.sh. ligjore, shoqërore, mjekësore ose psikologjike) të të miturit.

Neni. 3(6): Kur është e mundur të hamendësohet se qëndrimi në një Shtet Anëtar i një të mituri të pashoqëruar në moshë shkollë do të zgjatet, të miturit duhet t'i jepet mundësia e përdorimit të strukturave të arsimit të përgjithshëm me të njëjtat kushte të qytetarëve të Shtetit Anëtar pritisë ose përndryshe duhet t'i ofrohen mundësi të tjera shkollimi të përshtatshme.

Neni. 3(7): Të miturve të pashoqëruar duhet t'u jepet kujdesi i duhur shëndetësor për të plotësuar nevojat e ngutshme. Ndihmë e veçantë mjekësore apo e një lloji tjetër duhet t'u sigurohet të miturve që kanë vuajtur çdo formë të moskujdesit, shfrytëzimit ose abuzimit, torturës apo çdo lloj forme tjetër të trajtimeve apo dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese apo të konflikteve të armatosura.

Neni. 4(1): Çdo i mitur i pashoqëruar duhet të ketë të drejtën të paraqesë një kërkesë për azil. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të ruajnë të drejtën të kërkojnë që një i mitur nën një moshë të caktuar, e cila përcaktohet nga Shteti Anëtar përkatës, nuk mund të bëjë kërkesë për azil për sa kohë që nuk gëzon ndihmën e një kujdestari ligjor, një institucioni apo të një përfaqësuesi të rritur të caktuar posaçërisht.

Neni. 4(2): Duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të të miturve dhe gjendjen e tyre të pambrojtur, Shtetet Anëtare duhet ta trajtojnë procesin e kërkesës për azil të të miturve të pashoqëruar si një urgjencë.

Neni. 4(3): (a) Në parim, një azilkërkues i pashoqëruar që pretendon të jetë i mitur, duhet të japë prova për moshën e tij. (b) Nëse këto prova mungojnë ose ekzistojnë dyshime të forta, Shtetet Anëtare mund të bëjnë një vlerësim të moshës së azilkërkuesit. Vlerësimi i moshës duhet të bëhet objektivisht. Për qëllime të tilla, Shtetet Anëtare mund të zhvillojnë një test mjekësor moshe të kryer nga një personel mjekësor i kualifikuar, me miratimin e të miturit ose të një përfaqësuesi të rritur apo të një institucioni të caktuar posaçërisht.

Neni. 4(4): Gjatë procedurave të azilit, Shtetet Anëtare normalisht duhet t'i vendosin të miturit e pashoqëruar (a) me të afërm të rritur, (b) me një familje kujdestare, (c) në qendra pritjeje të përshtatura për miturit ose (d) në strehime të tjera me kushte të përshtatshme për të mitur, për shembull të tilla që t'u lejojnë atyre të jetojnë në mënyrë të pavarur por me mbështetjen e duhur. Shtetet Anëtare mund t'i vendosin të miturit e pashoqëruar të moshës 16 vjeç e lart në qendra pritjeje për azilkërkuesit e rritur.

Neni. 4(5): (a) Gjatë çdo interviste lidhur me kërkesën e tyre për azil, të miturit e pashoqëruar azilkërkues duhet të shoqërohen nga një kujdestar ligjor, një institucion ose një përfaqësues i rritur i caktuar posaçërisht, një anëtar i rritur i familjes së tyre ose një asistent ligjor. (b) Intervista duhet të kryhet nga agjentë me përvojën apo formimin e duhur. Rëndësia e një formimi të përshtatshëm për agjentët që intervistojnë të miturit e pashoqëruar që kërkojnë azil duhet të njihet siç i takon.

Neni. 4(6): Gjatë shqyrtimit të një kërkesë për azil të një të mituri të pashoqëruar, duhet të merren parasysh, përveç fakteve dhe rrethanave objektive, mosha e të miturit, pjekuria dhe zhvillimi mendor, dhe fakti që ai mund të ketë njohuri të kufizuara mbi kushtet në vendin e tij të origjinës.

Neni. 4(7): Sapo një të mituri të pashoqëruar i jepet statusi i refugjatit ose çdo e drejtë tjetër qëndrimi të përhershëm, duhet t'i sigurohet atij një strehim afatgjatë.

Neni. 5: Nëse një të mituri nuk i lejohej të zgjasë qëndrimin e tij në një Shtet Anëtar, Shteti Anëtar përkatës mund të rikthejë të miturin në vendin e tij të origjinës ose në një vend të tretë që është i gatshëm ta presë atë, vetëm nëse vërtetohet që, me të mbërritur atje, të miturit do t'i sigurohen pritja dhe përkujdesja e duhur, në funksion të nevojave të tij të moshës dhe shkallës së pavarësisë.

Neni. 5(2): Për sa kohë kthimi në këto kushte nuk është i mundur, Shtetet Anëtare duhet në parim të mundësojnë qëndrimin e të miturit në territorin e tyre.

Neni. 5(3a, c & d) Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet, me qëllim kthimin e të miturit, të bashkëpunojnë a) në ribashkimin e të miturve të pashoqëruar me anëtarë të tjerë të familjes së tyre, qoftë në vendin e origjinës së të miturit, qoftë në vendin ku këta anëtarë të familjes jetojnë; (c) me organizata ndërkombëtare si UNCHR-ja dhe UNICEF-i të cilat prej kohësh luajnë një rol aktiv në këshillimin e qeverive lidhur me udhëzimet mbi mënyrën e trajtimit të çështjes së të miturve të pashoqëruar, veçanërisht azilkërkuesve; (d) nëse rasti e kërkon, me organizata joqeveritare për të siguruar vënien në dispozicion të një infrastrukture pritjeje dhe përkujdesjeje në vendin ku i mituri do të kthehet.

EU Rez. Minimum, Këshilli i Rezolutës së BE mbi garancitë minimale për procedurat e azilit, qershor 1995

parag 1: Procedurat e azilit zbatohen në përputhje të plotë me Konventën e Gjenevës të v. 1951 dhe me Protokollin e Nju Jorkut të v. 1967 që ka të bëjë me Statusin e Refugjatit dhe me detyrime të tjera të së drejtës ndërkombëtare për sa i përket refugjatëve dhe të drejtave të njeriut. Në veçanti, procedurat pajtohen tërësisht me Nenin 1 të Konventës së v. 1951 që ka të bëjë me përkufizimin e nocionit të refugjatit, me Nenin 33 që lidhet me parimin e

'mos-shtypjes' dhe me Nenin 35 që ka të bëjë me bashkëpunimin me Zyrën e UNCHR-së, me qëllim lehtësimin e detyrës së saj për të mbikëqyrur zbatimin e dispozitave të Konventës.

para 26: Duhet marrë masa në mënyrë që të miturit e pashoqëruar që kërkojnë azil të përfaqësohen nga një i rritur apo një organ përgjegjës i caktuar posaçërisht nëse, bazuar në të drejtën kombëtare, ata nuk mund ta bëjnë vetë këtë. Gjatë intervistës, të miturit e pashoqëruar mund të shoqërohen nga ky i rritur apo përfaqësuesit e organit në fjalë. Këta persona duhet të mbrojnë interesat e fëmijës.

parag. 27: Gjatë shqyrtimit të formularit të aplikimit të të miturit të pashoqëruar, merren parasysh zhvillimi mendor dhe pjekuria e tij.

Konventa e Hagës, 1993, Konventa e Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijve dhe Bashkëpunimin në Lidhje me Birësimin në një vend tjetër, dhe Rekomandimi shoqëruar mbi Aplikimin e Konventës për Fëmijët Refugjatë

Link: <http://www.hcch.net/e/conventions/menu33e.html>

Konventa e Hagës, 1996, Konventa e Hagës mbi Juridiksionin, të Drejtën e Aplikueshme, Përforcimin dhe Bashkëpunimin në lidhje me Përgjegjësinë Prindërore dhe Masat për Mbrojtjen e Fëmijve, 1996

Link: <http://www.hcch.net/e/conventions/menu34e.html>

ICCPR, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966 (dhe Protokollin Opsional)

Neni. 8: Askush nuk mund të mbahet në skllavëri as në robëri apo të shtrëngohet të kryejë punë të detyruar.

Neni. 19: Çdokush ka të drejtën të ketë opinionet e tij pa ndërhyrje. Çdokush ka të drejtën e lirisë së të shprehurit.

Neni. 23(1): Familja ka të drejtën e mbrojtjes nga shteti.

Neni. 24(1): Çdo fëmijë, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtën e masave mbrojtëse që ia kërkon vetë statusi i tij si i mitur, nga ana e familjes, shoqërisë dhe Shtetit.

ICESCR, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966

Neni. 10(3): Masa të posaçme mbrojtëse duhet të merren në favor të fëmijëve, pa kurrfarë diskriminimi dhe fëmijët duhet të mbrohen nga shfrytëzimet ekonomik e social.

ICRMW, Konventa Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrues dhe të Anëtarëve të Familjeve të tyre, 1990

Neni. 44(1): Shtetet marrin masa për të siguruar mbrojtjen e unitetit të familjeve të punëtorëve migrues.

ILO C182, ILO Konventa lidhur me Ndalimin dhe Masat e Menjëhershme për Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, C182, 1999

Neni. 3: Termi "format më të egra të punës së fëmijës" përfshin shitjen dhe trafikimin e fëmijëve.

Protokollin Kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000

Neni. 19(2): Masat e paraqitura në këtë Protokoll duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që personat të mos bëhen objekt diskriminimi për arsyen se janë objekte të akteve të përmendura në nenin 6 të këtij Protokoll. Interpretimi dhe zbatimi i këtyre masave duhet të përputhet me parimet e mosdiskriminimit të njohura në nivel ndërkombëtar.

Protokolli mbi Trafikimin e Personave, Protokolli për Parandalimin, Zhdukjen dhe Dënimin e Trafikimit të Njerëzve, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000

Neni. 7: Çdo Shtet Palë merr parasysh t'i lejojë viktimat e trafikimit të qëndrojnë në territorin e tij, përkohësisht ose përgjithnjë, kur rasti e kërkon.

Neni. 14(2): Masat e paraqitura në këtë Protokoll duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që personat të mos bëhen objekt diskriminimi për arsyen se janë viktimat e një trafiku qeniesh njerëzore. Interpretimi dhe zbatimi i këtyre masave duhet të përputhet me parimet e mosdiskriminimit të njohura në nivel ndërkombëtar.

Protokolli lidhur me Statusin e Refugjatëve, 1967

Link: <http://www.unhcr.ch>

Rekomandim në Lidhje me Aplikimin e Konventës së Hagës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për sa i përket Birësimit në një vend tjetër tek Fëmijët Refugjatë dhe Fëmijë të Tjerë të Larguar nga Vendi i Tyre, Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Tetor 1994,

Link: <http://www.hcch.net/e/conventions/annexa33e.html>

Fëmijët Refugjatë: Udhëzime mbi Mbrojtjen dhe Kujdesin, UNHCR, 1994

Link: <http://www.separated-children-europe-programme.org/Global/framed.asp?source=Documents/Eng/Legislation/RefugeeChildren.pdf>

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut & Trafikimin, Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara nga UNHCHR mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Njerëzor, E/2002/68/Add.1, 20 Maj 2002

Link: [http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/\(Symbol\)/E.2002.68.Add.1.En?Opendocument](http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/(Symbol)/E.2002.68.Add.1.En?Opendocument)

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Fëmijëve të cilëve u Është Hequr Liria, 1990

Link: <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r113.htm>

UNHCR-AP, Axxhenda e UNHCR-së për Mbrojtjen, 2002

Pjesa III, Qëllimi 1(9): Shtetet, UNHCR-ja, OJQ-të dhe partnerët e tjerë duhet të punojnë për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve të ndarë, duke përfshirë vendosjen e tyre të përkohshme në familje kujdestare apo caktimin e kujdestarëve shtetërorë ose jo-shtetërorë si dhe monitorimin e këtyre masave *and* Shtetet duhet të kërkojnë zgjidhje të tjera që të zëvendësojnë arrestin e azilkërkesve dhe refugjatëve dhe të shmangin, në parim, arrestimin e fëmijëve.

Pjesa III, Qëllimi 6(2): Shtetet, UNHCR dhe partnerët e tyre duhet të marrin masa për të garantuar që fëmijët refugjatë të marrin pjesë në mënyrë të drejtë në proceset e vendimmarrjes, në të gjitha fushat e jetës së refugjatit, si dhe në vënien në zbatim të këtyre vendimeve *dhe* Shtetet duhet t'i japin rëndësi arsimit tetëvjeçar dhe të mesëm për refugjatët.

Udhëzimet e UNHCR-së, Udhëzimet e UNHCR-së mbi Politikat dhe Procedurat që duhen zbatuar lidhur me Fëmijët e Pashoqëruar që Kërkojnë Azil, 1997

Link: <http://www.unhcr.ch/cgi-bin/texis/vtx/home/opendoc.pdf?tbl=MEDIA&id=3d4f91cf4&page=publ>

Manuali i UNHCR-së, Manuali i UNHCR-së mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit, 1992

Link: <http://www.unhcr.ch/cgi-bin/texis/vtx/home/opendoc.pdf?tbl=MEDIA&id=3d58e13b4&page=publ>

Programi për Fëmijët e Ndarë në Europë është një nismë e përbashkët e disa anëtarëve të Aleancës Ndërkombëtare të Save the Children dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Programi bazohet në mandatet plotësuese dhe fushat e kompetencave të dy organizatave.

Përgjegjësia e UNHCR-së është të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve refugjatë dhe të atyre që kërkojnë azil. Aleanca Ndërkombëtare e Save the Children merr përsipër të mbikqyrë respektimin e plotë të të drejtave të të gjithë fëmijëve.

Fëmijët e ndarë janë fëmijë nën 18 vjeç të cilët ndodhen jashtë vendit të tyre të origjinës dhe janë të ndarë nga të dy prindrit apo nga kujdestarët e tyre të mëparshëm ligjorë/zakonorë. Programi synon të mbrojë të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijëve të ndarë të cilët kanë ardhur ose kalojnë nëpër Europë, duke krijuar një politikë të përbashkët dhe duke u angazhuar në praktikatat më të mira në nivel kombëtar dhe europian. Në kuadrin e këtij procesi, programi po krijon partneritet me organizata që punojnë me fëmijët e ndarë në vendet e Europës dhe po punon me institucionet europiane.

Kjo **Deklaratë e Praktikave të Mira** parashtrohet bazat e politikave dhe praktikave të nevojshme për punën e programit.

Ky përkthim në gjuhën shqipe bazohet në versionin e tretë në gjuhën angleze, 2004. Përkthimi dhe publikimi në gjuhën shqipe u financua nga Save the Children, Programi për Shqipërinë. Save the Children, Programi për Shqipërinë nuk është përgjegjës as për përdorimin dhe as për përmbajtjen e këtij botimi.

Doli nga shtypi në Mars të 2006

Fondet për programin janë siguruar nga:

Save the Children, Norvegji

Save the Children, Suedi

Save the Children, Danimarkë

Save the Children, MB

Save the Children, Itali

Fondi European për Refugjatët, Komisioni European

UNHCR

Vizatimi i kopertinës është riprodhim i një kalendari të publikuar nga Shoqata për Punën Parandaluese dhe Vullnetare, Lubjanë, Slloveni dhe riprodhohet këtu me lejen e Presidentit të mëparshëm të Shoqatës, Goran Flaker. Origjinali ishte një vizatim i një fëmije refugjat nga Bosnia, Osman Islamovic, të cilin ai e quajti – Paqe dhe Luftë.

Kopje të kësaj deklarate në Shqip mund t'i gjeni nëpërmjet:

Save the Children, Programi për Shqipërinë, Rruga Komuna Parisit, Vila Lami, Tiranë, Shqipëri.

Tel: + 355 4 266227, fax + 355 4 263428; e-mail savealbania@savealbania.org

Kopje të kësaj deklarate në Anglisht dhe Frengjisht mund t'i gjeni nëpërmjet:

Save the Children, Rosenørns Allé 12, DK-1634 Copenhagen V, Denmark

Tel: +45 35 36 55 55, Fax: +45 35 39 11 19, E-mail: rb@redbarnet.dk

UNHCR, Policy Unit, Bureau for Europe, 94 Rue Montbrillant, CH-1202 Geneva, Switzerland

Kontakt: Kirsti Floor, Tel: +41 22 739 83 80, Fax: +41 22 739 73 31/739 73 32,

E-mail: FLOOR@unhcr.ch

Deklarata e Praktikave të Mira mund gjithashtu të shkarkohet si dokument i formatit PDF nga www.separated-children-europe-programme.org